



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 13 regjistër (JR)  
Datë 17.03.2023

Nr. 56 i vendimit  
Datë 17.07.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

|                        |                 |
|------------------------|-----------------|
| <b>Sokol Çomo</b>      | <b>Kryesues</b> |
| <b>Mimoza Tasi</b>     | <b>Relatore</b> |
| <b>Albana Shtylla</b>  | <b>Anëtare</b>  |
| <b>Natasha Mulaj</b>   | <b>Anëtare</b>  |
| <b>Rezarta Schuetz</b> | <b>Anëtare</b>  |

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datën 17.07.2025, ditën e enjte, në orën 10:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Theo Jacobs, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, çështjen nr. 13/2023 (JR), datë 17.03.2023, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 597, datë 12.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet A, Ç, D dhe F, pika 2, të Aneksit të Kushtetutës; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në datën 17.07.2025, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 597, datë 12.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, dhe në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet ndihmëse përkatëse deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata vetting”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

3.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me subjektin e rivlerësimit, ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë*; (ii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iii) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (iv) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

3.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve në deklaratën për kontrollin e figurës dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin e deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.08.2020, të KDZh-së, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu: (a) *ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar*; (b) *ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si*

*ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat të mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

3.3. KLP-ja ka dërguar në Komision raportin vlerësues për subjektin e rivlerësimit, i cili është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Bazuar në kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), referuar neneve 71-76, KLP-ja ka analizuar lidhur me: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Kudusi Shahu, bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 597, datë 12.12.2022.

## **II. Vendimi i Komisionit**

5. Komisioni, me vendimin nr. 597, datë 12.12.2022, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kudusi Shahu, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.*
6. Ky vendim është marrë nga Komisioni, bazuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit:
  - a) Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit Kudusi Shahu gjendet në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
  - b) Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
  - c) Subjekti i rivlerësimit arrin nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

## **III. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me vendimin e Komisionit**

7. Subjekti i rivlerësimit, në datën 10.03.2023, i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), me ankim kundër vendimit nr. 597, datë 12.12.2022, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji, që pas marrjes në shqyrtim të shkaqeve të ankimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë: (i) *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike;* (ii) *Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 597, datë 12.12.2022;* (iii) *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kudusi Shahu, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.*

8. Në ankimin drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, kundër vendimit nr. 597, datë 12.12.2022, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit parashtrohet shkaqe ankimi lidhur me procesin e rregullt ligjor, si dhe lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Pretendimet për procesin e zhvilluar nga Komisioni kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të gjyqimit nga një gjykatë e paanshme, në kushtet e mungesës së kontradiktoritetit dhe debatit juridik dhe të një vendimi të dhënë bazuar vetëm në kriterin e pasurisë; shkeljen e parimit të barazisë së armëve; shkelje të nenit 8 të KEDNj-së për respektimin e të drejtës së jetës private dhe familjare; shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe cenimin e të drejtës së ankimit, për shkak të arsytimit dhe zbardhjes së vendimit përtej afatit 30-ditor.

#### **- Shkaqe ankimi lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

9. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit në ankim: (i) për pasurinë banesë 2 kate, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, pretendon se Komisioni ka gabuar në lidhje me kohën e ndërtimit, analizën e kostove të ndërtimit dhe të ardhurave të përdorura për ndërtimin e banesës dhe nuk ka marrë në konsideratë asnjë dokument dhe argument të paraqitur prej tij në lidhje me vlerën e investimit; (ii) për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, në Tiranë, kundërshton konkluzionin e Komisionit për mundësinë e kursimeve dhe pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2006; (iii) për pasurinë apartament, në Golem, kërkon që të njihet si burim huaja e dhënë nga personi tjetër i lidhur, shtetasi B. H.; (iv) për pasurinë garazh me sipërfaqe 24,8 m<sup>2</sup>, në Tiranë, kërkon të njihet kontributi i vjehrrit të tij në blerjen e kësaj pasurie; (v) kërkon konsiderimin si të ligjshme të të ardhurave nga emigracioni të personit tjetër të lidhur, vëllait të tij B. Sh.; si dhe (vi) përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortes nga mësimdhënia dhe të të ardhurave nga dhënia me qira e apartamentit të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”.

### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

#### **A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit**

##### *a) Mbi juridiksionin e Kolegjit*

10. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### *b) Mbi legjitimitimin e ankuesit*

11. Ankuesi Kudusi Shahu, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtuar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe në zbatim të nenit F, pika 2 e

Aneksit të Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

12. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Kudus Shahu, është shpallur në seancë publike më datë 12.12.2022. Vendimi i arsyetuar nr. 597, datë 12.12.2022, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.02.2023, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 27.02.2023. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në datën 10.03.2023, pranë Komisionit, ankimin e tij kundër vendimit nr. 597, datë 12.12.2022, të Komisionit, protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.03.2023. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

c) Mbi formën e gjykimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
14. Në parashtrimet e paraqitura përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, në të cilat ka konfirmuar sa ka argumentuar dhe në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur disa dokumente<sup>1</sup>, për të cilat ka parashtruar se shërbejnë për të vërtetuar rrethana

---

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit kërkoj të administrohen si prova aktet: (i) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.06.2025, e shtetasit D. Gj.; (ii) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.06.2025, e shtetasit Xh. K.; (iii) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.06.2025, e shtetasit M. Rr., inxhinier gjeolog; (iv) Vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 17.06.2025, i Njësisë Administrative nr. {\*\*\*}, që vërteton ushtrimin e detyrës së kryeplakut nga z. B. në periudhën 1992–2012; (v) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.06.2025, e shtetasit Xh. B.; (vi) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.10.2024, e shtetasit T. T., inxhinier ndërtimi, së bashku me raportin e vlerësimit të objektit në vitin 2003; (vii) Raporti gjeologo inxhinierik shkurt 1997, përgatitur nga ing. M. S. dhe ing. M. Rr.; (viii) Certifikatë vdekjeje e inxhinierit A. J.; (ix) Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 25.06.2025, e KESH; (x) Nëntë fatura origjinale për blerje materiale ndërtimi, të periudhës 15.06.2002–03.08.2002; (xi) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.06.2025, e shtetasit A. B.; (xii) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.06.2025, e shtetasit K. P.; (xiii) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.06.2025, e shtetasit G. D.; (xiv) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.06.2025, e shtetasit K. H.; (xv) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.06.2025, e shtetasit D. I.; (xvi) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.06.2025, e shtetasit S. Ll.; (xvii) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.06.2025, e shtetasit O. D.; (xviii) Dy blloqe programi dhe kursesh të gjuhës angleze; (xix) Vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 26.11.2024, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, mbi pagesën e tatimeve në vitet 2019–2022 nga bashkëshortja e subjektit, znj. E. Sh., për periudhën respektive; (xx) Vendime të Këshillit të Ministrave që përcaktojnë përfitimet e natyrës së kompensimit ushqimor dhe veshmbathje për funksionarët e drejtësisë ushtarake në vitet përkatëse; (xxi) Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2024, nga AKBN; (xxii) Kërkesë për informacion drejtuar AKBN-së, protokolluar nr. {\*\*\*} prot., datë 29.10.2024; (xxiii) Opinion Ligjor, Studio Ligjore {\*\*\*}; (xxiv) Dokumenti nga UK Visas Emigration; (xxv) Akt ekspertimi kontabël i datës 05.03.2025, hartuar nga ekspertja auditues ligjor E.

thelbësore lidhur me kriterin e pasurisë dhe burimet e ligjshme të të ardhurave të subjektit dhe personave të lidhur, duke kërkuar që të administrohen si prova të reja.

15. Trupi gjykues, pasi i vlerësoi këto akte nën dritën e parashikimeve të neneve 47<sup>2</sup> dhe 49, pika 2<sup>3</sup> e ligjit nr. 49/2012, çmoi se nuk legjitimohet pranimi i tyre me cilësinë e provës, në kushtet që subjekti nuk ka argumentuar se cili ka qenë shkaku që i ka krijuar pengesën apo pamundësinë e paraqitjes së këtyre provave gjatë hetimit administrativ në Komision. Konkretisht, nga shqyrtimi i këtyre akteve konstatohet se deklaratat noteriale të pronarëve kufitarë me pasurinë banesë 2 kate, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë dhe të inxhinierit M. R., si dhe shkresa e KESh-së, që vërteton lidhjen e energjisë në banesë në vitin 2003, të cituara në nëndarjet (i)-(iii) dhe (ix) të poshtëshënimit nr. 1, janë akte të reja të hartuara pas dhënies së vendimit të Komisionit, por që subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë pengesë për t’i paraqitur më parë, gjatë hetimit administrativ në Komision. I njëjti konstatim qëndron dhe për faturat e blerjeve të materialeve të ndërtimit të vitit 2002 apo raportin për vlerësimin e objektit i vitit 2003, akte të cilat subjekti i rivlerësimit i dispononte dhe mund t’i paraqiste në Komision.
16. Edhe duke abstraguuar nga analiza e kriterëve për pranimin e provave të reja në ankim, trupi gjykues vëren se nën dritën e parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, këto akte u vlerësuan të panevojshme e të parëndësishme për vendimmarrjen.

**16.1.** Konkretisht, për sa u përket deklaratave noteriale të vitit 2025 të prindërve të fëmijëve, të cilët kanë zhvilluar kurse të gjuhës angleze me bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, si dhe të blloqeve të programit të kurseve, të cituara në nëndarjet (xi)-(xviii), të poshtëshënimit nr. 1, trupi gjykues vëren se në këto akte nuk rezulton asnjë informacion mbi pagesat e kryera, që do të mund të jepnin indicie mbi të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Ndërsa vërtetimi nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2024, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, jep të dhëna për pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat për një periudhë jashtë periudhës së rivlerësimit (nga viti 2019 e në vazhdim), të dhëna të cilat nuk i shërbejnë procesit.

**16.2.** Në lidhje me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2024, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, që vërteton angazhimin profesional të z. H. B., vjehrrit i subjektit të rivlerësimit, në projekte gjeologjike me pagesë si inxhinier shtetëror, së bashku me projektet respektive, trupi gjykues vëren se ky akt nuk jep asnjë indicie mbi vlerën e të ardhurave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit apo ndonjë vlerë tjetër qoftë edhe të ndryshme.

**16.3.** Trupi gjykues, gjithashtu, vëren se dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, me të cilat ka dashur të provojë qëndrimin e vëllait të tij në Mbretërinë e Bashkuar apo pamundësinë për të marrë të dhëna mbi llogarinë bankare dhe transfertat e kryera nëpërmjet Western Union nga vëllai i tij, nuk sjellin të dhëna zyrtare mbi punësimin apo të ardhurat e realizuara nga vëllait në emigracion. Ndërkohë, konstatohet se dokumenti i lëshuar nga UK

---

H.; (xxvi) Tabelë excel, analizë shpenzime dhe të ardhura; (xxvii) E-mail Av. V. B., pranë Studio {\*\*\*}, mbi kërkimin për dokumente pranë Western Union London.

<sup>2</sup> Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.

<sup>3</sup> Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.

*Visas & Immigration*, është depozituar më parë nga subjekti i rivlerësimit në Komision, në përgjigje të rezultateve të hetimit.

17. Në përmbledhje dhe si konkluzion i sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se aktet e reja të paraqitura në parashtrime nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar dispozitave të sipërcituara ligjore dhe, për rrjedhojë, u refuzua marrja e tyre.
18. Për sa i përket kërkesës së subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues, pasi kontrollon zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision në aspektin procedural, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

#### **B. 1 Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me procesin e rregullt**

19. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe paanshme, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor, pasi është i njëjti trup gjykues që ka hetuar, administruar dhe çmuar provat dhe më pas ka dhënë vendimin ndaj tij. Për sa parashtron subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se procesi i zhvilluar nga Komisioni dhe mënyra sesi ai merr vendime kanë kaluar disa filtra të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, përfshirë nenin 6 të KEDNj-së, sikurse rezulton nga opinioni i Komisionit të Venecias nr. 868/2016 [CDL-AD(2016)036], arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, si dhe nga vendimi i GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*. Në këtë vendim, GjEDNj-ja ka vlerësuar se hetimi, gjykimi dhe marrja e vendimit nga e njëjta trupë gjykuese nuk përbënte cenim të parimit të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së<sup>4</sup>. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar.
20. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimmarrja e Komisionit e bazuar vetëm në një kriter, atë të pasurisë, është paragjyqese dhe në kundërshtim me nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, trupi gjykues sjell në vëmendje se neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave*. Nëse Komisioni arrin në përfundimin se provat kanë një nivel të tillë provueshmërie, sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, lexuar në harmoni me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe interpretimi logjik i nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që bëjnë të besohet se subjekti i rivlerësimit gjendet para prezumimit ligjor të vendosjes së

<sup>4</sup> [...] 308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkuarës, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkuarës. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkuarës nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivist në lidhje me paanësinë e KPK-së.

masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter dhe të marrë një vendim për shkarkimin e tij, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej me verifikimin e kriterëve të tjera. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shkaku i ankimit i subjektit të rivlerësimit se procesi i tij i rivlerësimit është kryer në interpretim të gabuar të ligjit, pasi është konkluduar vetëm për një kriter, nuk gjendet i bazuar.

21. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kriterëve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin tashmë të konsoliduar në vendimmarrjet e Kolegjit<sup>5</sup>, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi i secilit kriter rivlerësimi (atij të pasurisë dhe pastërtisë së figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për kriterin objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.
22. Subjekti pretendon se dhënia e masës shkarkim nga detyra nga Komisioni është bërë në shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Mungesa e një analize të balancuar mes interesit publik të procesit të rivlerësimit dhe mbrojtjes së privatësisë së personave të lidhur me subjektin, si dhe mospërdorimi i mekanizmave që do të lejonin dëgjimin e tyre në kushte të sigurt, sipas subjektit të rivlerësimit, përbën ndërhyrje disproporcionale në këtë të drejtë të mbrojtur. Në vlerësim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren se, në kushtet që vendimi i marrë nga Komisioni bazohet në ligj dhe ky i fundit ka kaluar kontrollin e kushtetutshmërisë dhe atë të përputhshmërisë me garancitë e sanksionuara nga KEDNj-ja, pretendimi i subjektit, për cenim të të drejtës për jetë private, është i pabazuar. Në të njëjtën kohë, dhe po aq e rëndësishme, është të theksohet se nuk mund të argumentohet se vendimi i Komisionit shkel parimin e proporcionalitetit në kushtet që ka qenë rezultat i zbatimit të normës ligjore të parashikuar nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.
23. Për sa i përket pretendimit për shkeljen e afatit 30-ditor të arsytimit të vendimit nga Komisioni dhe për cenim të të drejtës së ankimit, trupi gjykues konstaton nga aktet procedurale në fashikuj se seanca dëgjimore në Komision është zhvilluar në datën 07.12.2022, ndërsa në seancën e datës 12.12.2022 është shpallur vendimi në prezencë dhe të subjektit të rivlerësimit. Vendimi i Komisionit i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.02.2023 dhe është marrë prej tij në datën 27.02.2023, sipas aktit “Lajmërim marrje” të Postës Shqiptare. Nga këto të dhëna, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në rastin konkret vonesa në arsytimin e vendimit, tej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet jorelevante dhe nuk ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për akses

---

<sup>5</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 13/2020 (JR); nr. 34/2021 (JR); nr. 12/2022 (JR); nr. 49/2023 (JR).



në gjykatë, sa kohë ky i fundit ka ushtruar ankim brenda afatit ligjor dhe ankimi i tij është marrë në shqyrtim nga Kolegji në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

24. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim se vendimi i Komisionit është marrë në kushtet e mungesës së kontradiktoritetit dhe debatit juridik dhe në shkelje të parimit të barazisë së armëve, pasi Komisioni nuk ka analizuar provat dhe sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk i ka dhënë mundësinë për të debatuar gjetjet gjatë seancave dëgjimore, trupi gjykues konstaton se ky shkak ankimi është artikuluar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk mundëson vlerësimin e bazueshmërisë së tij në kuptim të vlerësimit të pretendimeve konkrete të subjektit të rivlerësimit dhe evidentimit të fakteve të pavërteta, fakteve të mohuara apo të keqinterpretuara nga Komisioni. Në çdo rast, në vlerësim të trupit gjykues, shqyrtimi i këtij shkakui bëhet pjesë e analizës së shkaqeve të ngritura në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kundërshtimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të konkluzioneve të Komisionit, të cilat kanë çuar në vendimmarrjen objekt kontrolli.

## **B.2 Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

**- Për pasurinë banesë 2 kate + papafingo + bodrum, me sipërfaqe totale 436,1 m<sup>2</sup>, në Tiranë**

25. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Banesë në rrugën “{\*\*\*}”, (me leje legalizimi nr. {\*\*\*} datë 03.03.2009, mbi truallin, pika 2), me sipërfaqe ndërtimi 110,3 m<sup>2</sup>, 2 kate + papafingo+bodrum), e ndërtuar mbi truallin në z.k. {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}. Vlera: 4.000.000 lekë (nga rivlerësimi nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, me shumën 36.425.345 lekë). Në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabarta”. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kursimet nga paga e tij në vitet 1991-2004 dhe e bashkëshortes nga viti 2004. Nga shitja e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, pall. {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, në vlerën 2.000.000 lekë (kontratë nr. {\*\*\*}/rep/kol., datë 08.10.2004), që është përfituar nga EKB-ja Tiranë, sipas kontratës me kusht nr. {\*\*\*}/rep/kol., datë 20.04.1999, e më pas me kontratë shitje nr. {\*\*\*}/rep/kol., datë 16.10.2004”. Në seksionin e të dhënave konfidenciale, pasi përshkruan si burim të ardhurat nga pagat në vitet 1991-2004 dhe shitjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”), në shumën 2.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në ndërtimin e kësaj banese ka kontribuar në vlerë të papërcaktuar dhe vëllai B. Sh., si rezultat i emigracionit në Greqi dhe Angli (pa kontratë, me deklaratë), i cili, gjithashtu, ka kontribuar dhe në arredimin dhe rregullimin e banesës në Golem, duke u bërë automatikisht bashkëpronar me marrëveshje në këtë apartament të shfrytëzuar bashkërisht sipas nevojave. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera e përgjithshme e kontributit të vëllait, si në ndërtimin e banesës së mësipërme dhe të asaj të ndodhur në Golem, arrin afërsisht 27.000 euro.*
26. Për këtë pasuri, Komisioni në vendim ka konkluduar se referuar analizës financiare tërësore të investimit të kryer në banesën në rrugën “{\*\*\*}”, për të gjithë burimet, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare: (i) në vlerën 6.100.570 lekë gjatë periudhës 1993 – 2003, për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive dhe kryerjen e investimit në banesën objekt analize, duke u

gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) në vlerën 698.124 lekë gjatë vitit 2004, për kryerjen e shpenzimeve dhe të investimit në banesën objekt analize, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaraten e pasurisë *vetting*, duke mosdeklaruar kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, të cilat kërkojnë përcaktimin e qartë të kohës së krijimit të pasurive në pronësi që deklarohen në deklaraten e pasurisë *vetting*, situatë faktike e cila bie ndesh me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

27. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, pretendon se Komisioni ka gabuar në lidhje me analizën e kostove të ndërtimit dhe të të ardhurave të përdorura për ndërtimin e banesës, pasi nuk ka marrë në konsideratë asnjë dokument dhe argument të paraqitur prej tij në lidhje me vlerën e investimit 4.000.000 lekë. Punimet e ndërtimit kanë filluar në vitin 1997 dhe është i pabazuar konkluzioni i Komisionit që ka konsideruar si periudhë ndërtimi të objektit vitet 2003-2004. Konkluzionet e gabuara të Komisionit mbi vitin e ndërtimit dhe mbi përlllogaritjet për metër katror të kostos së ndërtimit, pa marrë në konsideratë strukturën e objektit, kanë sjellë një vlerë joproporcionale në investimin e kryer, duke përmbysur automatikisht edhe përlllogaritjet në raportin të ardhura kundrejt shpenzimeve.
28. Në lidhje me këtë shkak ankimi, në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, trupi gjykues analizon dhe vlerëson si vijon.

**- Lidhur me përcaktimin e momentit të fillimit të punimeve për ndërtimin e banesës**

29. Për sa i përket momentit të fillimit të ndërtimit të banesës, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se:
  - (i) Në deklaraten *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vitin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve të ndërtimit të banesës;
  - (ii) Në deklaraten e parë të pasurisë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë deklarim lidhur me këtë banesë;
  - (iii) Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar banesën dhe koston e ndërtimit të saj vetëm në deklaraten periodike vjetore të vitit 2004, në të cilën deklaroi: *“Banesë private e palegalizuar në rrugën “{\*\*\*}”, me vlerë 4 milion lekë, me pjesë zotëruese 1/5”*.
  - (iv) Sipas procesverbalit të datës 01.02.2016, të mbajtur nga ILDKPKI-ja, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se banesa është ndërtuar për periudhën 1997 e në vazhdim.
  - (v) Në pyetësin standard të dërguar nga Komisioni, në përgjigje të pyetjes nr. 9, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Ndërtimi i banesës nga viti 2001 e në vazhdim në rrugën “{\*\*\*}”, me vlerë 4.000.000 lekë [...]”* dhe, në vijim, në përgjigje të pyetjes nr. 14, është shprehur se *shtëpia është ndërtuar në vitet 1995-1996 [...]*. Në këtë pyetësor, subjekti ka deklaruar se nga viti 2002 e aktualisht jeton në të njëjtën njësi administrative në rrugën *“{\*\*\*}”* (ish-rruga *“{\*\*\*}”*).
  - (vi) Në pyetësin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se data e fillimit të ndërtimit të banesës ka qenë nga viti 1997 dhe ka përfunduar me përafërsi nga viti 2007, pasi është ndërtuar pjesë-pjesë dhe njëkohësisht kur ka banuar aty është bërë dhe vazhdimi i

punimeve për pjesën tjetër të banesës. Subjekti, bashkëlidhur këtij pyetësori, ka paraqitur vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 06.07.2022, të Njesisë Administrative, Njësia Bashkiake nr. {\*\*\*}, Tiranë, sipas së cilit qytetari Kudusi Shahu është banor i Njesisë Administrative nr. {\*\*\*}, në adresën rruga “{\*\*\*}”, nd. {\*\*\*}, Tiranë dhe se kjo banesë është prej tij nga viti 1997 e në vazhdim.

(vii) Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka paraqitur në Komision kontratën e sipërmarrjes të datës 16.10.1997, lidhur ndërmjet subjektit në cilësinë e “investitorit dhe pronarit të truallit” dhe inxhinierit A. J., në cilësinë e sipërmarrësit, ku përcaktohet se: *“Kudusi Shahu është pronar i një sipërfaqe toke 302,6 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Pronësia e mësipërme vërtetohet me kontratën e shitblerjes së truallit. Pronari i truallit vë në dispozicion të sipërmarrësit pronën e mësipërme për të ndërtuar shtëpi banimi 2 kate + nënçati, me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>”.*

30. Në kushtet e deklarimeve kontradiktore nga ana e subjektit, lidhur me periudhën e fillimit dhe përfundimit të ndërtimit të objektit, si dhe në kushtet e informacionit të paplotë në dokumentacionin e administruar, Komisioni ka verifikuar pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar, konkretisht ortofoto të viteve 1999 dhe 2001 të përcjella nga Autoriteti për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), nga të cilat ka rezultuar se pavarësisht se këto pamje nuk ishin plotësisht të qarta, në parcelën konkrete nuk dallohet të ketë ndërtim në proces. Gjithashtu, Komisioni ka verifikuar edhe pamjet imazherike nëpërmjet platformës *google earth* dhe, bazuar në koordinatat gjeografike të banesës, ka konstatuar se: (i) në imazhin e datës 17.06.2002 në parcelë vërehet një njollë e zbehtë; dhe (ii) në imazhin e datës 16.02.2003 dallohet çatia e përfunduar e këtij objekti.

31. Komisioni e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e subjektit se momenti i fillimit të punimeve të ndërtimit është viti 1997, bazuar në kontratën e sipërmarrjes datë 16.10.1997 dhe në vërtetimin e Njesisë Administrative Nr. {\*\*\*}, pasi: (i) kontrata e sipërmarrjes së datës 16.10.1997 tregon një angazhim në të ardhmen dhe mbetet në kuadrin e një parashikimi; (ii) momenti i dakordësimit verbalisht me pronarët e truallit për pozicionin e parcelës dhe çmimin e shitjes nuk mund të vërtetojë momentin e fillimit të ndërtimit; (iii) konfirmimi i Njesisë Administrative Nr. {\*\*\*}, për vitin e fillimit të punimeve, nuk bazohet në ndonjë dokumentacion dhe, gjithashtu, në aktet e Bashkisë Tiranë, të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, nuk paraqitet asnjë e dhënë lidhur me vitin e fillimit të punimeve. Sipas Komisionit, një sërë provash të administruara gjatë hetimit administrativ provojnë të kundërtën e pretendimit të subjektit të rivlerësimit, dhe, konkretisht, prova thelbësore, e cila kundërshton pretendimin e subjektit janë pamjet imazherike të printuara nga Gjeoportali Kombëtar, konkretisht ortofotot e viteve 1999 dhe 2001, të përcjella nga ASIG, ku evidentohet qartazi se në parcelën konkrete në këtë periudhë nuk ka gjurmë ndërtimi dhe ajo gjendet në formë natyrore, çka përjashton në mënyrë absolute fillimin e ndërtimit në vitin 1997. Komisioni ka argumentuar se kjo provë e kërkuar dhe administruar sipas kërkesave të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim përcaktimin e fillimit dhe përfundimit të ndërtimit, është gjithashtu një nga format e përcaktuara për verifikimin e ndërtimeve informale, sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 588, datë 10.09.2014 dhe konsiderohet ekuivalent me përdorimin e një harte.

32. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar të konsiderojë pamjet imazherike të *google earth*, për shkak se: (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta në deklaratat vjetore dhe ka qenë i paqartë dhe kontradiktor në deklarimet e tij pranë ILDKPKI-së dhe gjatë hetimit administrativ; (ii) informacioni i administruar nga institucionet përkatëse është i paplotë. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar se, pavarësisht se nuk mund të përcaktohet me saktësi lloji i punimeve të kryera, ndërtimi i objektit ka filluar në vitin 2002 dhe jo në vitin 1997, siç pretendon subjekti. Në këto kushte, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke mosdeklaruar kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, të cilat kërkojnë përcaktimin e qartë të kohës së krijimit të pasurive në pronësi që deklarohen në deklaratën e pasurisë *vetting*, situatë faktike e cila bie ndesh me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
33. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit parashtron se punimet për ndërtimin e banesës kanë filluar në vitin 1997, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 16.10.1997, pasi ai është dakordësuar me pronarët e truallit për pozicionin e parcelës dhe çmimin e shitjes dhe, po këtë vit, ka filluar procedura për pajisjen me certifikatë pronësie të pronarëve të truallit, pasi kishte parregullsi në dokumentacionin pranë ZVRPP-së. Sipas tij, në kushtet e mungesës së dokumenteve ligjore të pronarit/shitësit të truallit, lidhja e kontratës për shitblerjen e truallit është realizuar në vitin 2001, nëpërmjet kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.02.2001.
34. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit e bazon pretendimin e tij për fillimin e punimeve në vitin 1997 në kontratën e thjeshtë (jonoteriale) të sipërmarrjes, të lidhur në datën 16.10.1997, ndërmjet tij, në cilësinë e investitorit dhe pronarit të truallit, dhe inxhinierit A. J., në cilësinë e sipërmarrësit. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të kishte bërë një vlerësim real të këtij akti juridik, që duhet të lexohet dhe interpretohet në tërësinë e tij. Nga verifikimi i përmbajtjes së këtij akti, rezulton se në të citohet se *Kudusi Shahu është pronar i një sipërfaqeje toke 302,6 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Pronësia e mësipërme vërtetohet me kontratën e shitblerjes së truallit*. Trupi gjykues vëren se të dhënat e kontratës bien në kundërshtim me deklarimet dhe situatën faktike të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me pronësinë e truallit në vitin 1997. Ndërsa në kontratën e sipërmarrjes subjekti i rivlerësimit konsiderohet pronar i truallit, si në prapësimet në Komision, ashtu edhe në ankimin drejtuar Kolegjit ai ka parashtruar se pronarët të cilët i kanë shitur truallin kanë pasur parregullsi në dokumentacion dhe nuk kanë qenë të pajisur me certifikatë pronësie në vitin 1997. Megjithatë në kontratën e sipërmarrjes referohet për një kontratë shitblerjeje trualli, nga aktet rezulton se vetëm pas 4 vitesh nga nënshkrimi i kontratës së sipërmarrjes është realizuar dhe formalizuar shitja e truallit me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.02.2001, akt që vetë subjekti e ka paraqitur në Komision. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 16.10.2000, të bashkëpronarëve të truallit, nënshkruar dhe nga vetë subjekti, sipas së cilës rezulton se në këtë datë është kryer pagesa e një pjese të vlerës së truallit dhe pjesa tjetër është likuiduar me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.02.2001. Sipas këtyre dy akteve

juridike rezulton se marrëdhënia faktike, formale e subjektit me truallin ka filluar në vitin 2000, dhe se ai nuk ka pasur asnjë pengesë që ta kryente pagesën e parë për blerjen e truallit dhe më herët, pa u formalizuar kontratat e shitblerjes së truallit, nisur nga pretendimi i tij që ishte dakordësuar çmimi i shitjes dhe kishin filluar punimet që në vitin 1997. Këto akte dhe rrethana konfirmojnë qëndrimin e Komisionit se momenti i dakordësimit verbalisht me pronarët e truallit për pozicionin e parcelës dhe çmimin e shitjes nuk mund të vërtetojë momentin e fillimit të ndërtimit. Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pronar i truallit në vitin 1997 e bën të pabesueshëm pretendimin e tij se ka filluar ndërtimin e banesës që në vitin 1997, mbi një truall, statusi juridik i të cilit ka qenë i paqartë, për shkak të mungesës së dokumentacionit të pronësisë edhe nga vetë pronarët realë të tij në këtë periudhë.

35. Referuar akteve në fashikuj, konkretisht dosjes së kësaj pasurie të dërguar në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, sipas formularit të vetëdeklarimit “Për legalizim objekti”, subjekti i rivlerësimit ka aplikuar për legalizimin e objektit “godinë banimi”, me këto të dhëna: *adresa rruga “{\*\*\*}”, funksioni “banim”, vit ndërtimi 2000, sipërfaqe e zënë 303 m<sup>2</sup>*. Edhe sipas këtij dokumenti, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, në kuadër të procesit të legalizimit të banesës, nuk provohet pretendimi i tij se ndërtimi ka filluar në vitin 1997.
36. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka filluar të banojë në këtë banesë që në vitin 2002, sipas deklarimit të tij në pyetësin standard, dhe se punimet për ndërtimin e banesës kanë vazhduar në vite, gjatë kohës që ai dhe familja e tij kishin filluar të banonin. Trupi gjykues konstaton se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk arrin të provohet, si nga aktet e sjella prej tij, ashtu edhe nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Sipas të dhënave të dërguara në Komision nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (në vijim “FShU”) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë (në vijim “OSHe”), për objektin në rrugën “{\*\*\*}” (ish “{\*\*\*}”), vërtetohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrime të pashlyera nga viti 2010 e në vazhdim, por nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata të mëparshme të lidhura nga subjekti para këtij viti, që do të provonin pretendimin e tij se ka filluar të banojë që prej vitit 2002. Nga informacioni i dërguar nga FShU-ja rezulton se kontrata e energjisë elektrike për banesën në rrugën “{\*\*\*}” është lidhur në datën 28.06.2010 dhe faturimi e pagesat fillojnë nga nëntori 2010. Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka aplikuar në datën 14.05.2010, pranë Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, për të lidhur kontratën e furnizimit me ujë për banesën. Kërkesës së Komisionit në pyetësin nr. 1, për të paraqitur dokumentacionin ligjor që provon pagesën e konsumit të energjisë elektrike dhe të furnizimit me ujë, për periudhën 2002-2010, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se ka pasur një kontratë për furnizimin me energji elektrike, por ka pasur një ngatërresë të emrit të tij dhe, për këtë arsye, nuk gjendet. Ndërsa për furnizimin me ujë, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se me sa i kujtohet kontrata është lidhur para vitit 2010 dhe është në kërkim të dokumentacionit përkatës, pasi mund të jetë me emër tjetër ose me mangësi në të dhënat e tij. Konstatohet se në vazhdim të procesit të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ka sjellë asnjë akt tjetër për të provuar lidhjen e kontratave të furnizimit me ujë dhe energji elektrike para vitit 2010.
37. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për vitin e fillimit të ndërtimit të banesës dhe se kur ka filluar të banojë në të, nuk mbështeten as nga deklarimet e tij në deklaratat periodike vjetore. Konkretisht, në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003,

subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm truallin tokë me sipërfaqe 302 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, në vlerë 1.300.000 lekë, që i korrespondon vlerës së blerjes së truallit, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.02.2001. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar si adresë banimi apartamentin në rrugën “{\*\*\*}” dhe për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2004 deklaroi si adresë banimi banesën në rrugën “{\*\*\*}”. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, të datës 05.12.2022, subjekti ka sqaruar se: *“Lidhur me deklarin e kësaj pasurie pranoj që nga ana ime ka pasur pasaktësi në lidhje me këtë pasuri. Në deklaratën e parë pranë ILDKPKI-së nga ana ime nuk është deklaruar kjo pasuri. Mosdeklarimi i kësaj pasurie në deklaratën e parë, përpos faktit që ishim të pa trajnuar dhe mirinformuar mbi mënyrën se si duhej të plotësohej deklarata, ishte edhe fakti që kjo pasuri nuk kishte akoma një status juridik të përcaktuar. Konkretisht, ishte një pasuri (ndërtesë në ndërtim) e paregjistruar, e pa legalizuar dhe ndërkohë në kohën e deklarimit nga ana ime nuk kishte një vlerë të saktë të përcaktuar të vlerës së ndërtimit dhe detyrimeve të furnitorëve për materiale dhe ndoshta të punimeve të kryera”*.

38. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, kundërshton konkluzionin e Komisionit se ndërtimi i banesës ka filluar në vitin 2002, duke pretenduar se Komisioni u është referuar pamjeve jo të qarta nga *google earth* dhe mbi bazën e kësaj paqartësie ka konkluduar se koha e ndërtimit është në periudhën 2003-2004. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve në fashikull, rezulton se Komisioni, bazuar në të dhënat që vetë subjekti ka deklaruar për koordinatat e parcelës ndërtimore në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka kryer verifikimet në platformën *google earth* dhe ka konstatuar se: (i) në imazhin e datës 17.06.2002, në parcelë vërehet një njollë e zbehtë; dhe (ii) në imazhin e datës 16.02.2003, dallohet çatia e përfunduar e këtij objekti. Trupi gjykues çmon se, ashtu si dhe Komisioni ka referuar në vendim, se të dhënat e përfituara nga imazhet satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm (në këtë rast *google earth*), sipas nenit 3 të VKM-së nr. 588, datë 10.09.2014, konsiderohen si një nga metodat për verifikimin e ndërtimeve informale dhe ekuivalente me përdorimin e një harte. Bazuar në të dhënat e imazheve satelitore, si dhe në të dhënat e sjella nga ASIG, sipas së cilave rezulton se deri në vitin 2001 në gjurmën e parcelës nuk rezulton të ketë ndërtime, si dhe në indiciet e tjera të sipërcituara si: marrëdhënia me pronarët e truallit, deklarin e subjektit gjatë procesit të legalizimit apo deklarin e tij në deklarin e periodike vjetore, trupi gjykues arrin në të njëjtin konkluzion si Komisioni se ndërtimi i banesës ka filluar në vitin 2002 dhe jo në vitin 1997, sikundër pretendon subjekti i rivlerësimit. Në këtë konkluzion, nga Kolegji, një peshë e rëndësishme i është dhënë edhe faktit se deklarimi i parë i subjektit për këtë banesë është bërë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, deklarimi më i afërt lidhur me momentin e krijimit të kësaj pasurie, i cili është i pandikuar nga nevoja për rregullime në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.
39. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e ngritura në ankim lidhur me periudhën e ndërtimit të kësaj banese nuk gjenden të bazuara në rrethanat faktike, si dhe në aktet e administruara. Për rrjedhojë, mbetet i bazuar qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke mosdeklaruar kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, të cilat kërkojnë përcaktimin e qartë të kohës së krijimit të pasurive në pronësi

që deklarohen në deklaratën e pasurisë *vetting*, situatë faktike e cila bie ndesh me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

**- Në lidhje me mënyrën e përlllogaritjes së investimit**

40. Komisioni ka konkluduar se punimet për ndërtimin e banesës kanë filluar në vitin 2002, por për shkak se nuk mund të përcaktohet saktësisht lloji apo volumi i punimeve, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor për të vërtetuar koston e objektit, ka vendosur që vlerën e investimit ta përlllogarisë duke u bazuar në mesataren e koston së ndërtimit sipas EKB-së, për vitet 2002, 2003 dhe 2004 dhe ta shpërndajë në vitet 2003 dhe 2004. Bazuar në konkluzionin si më sipër, Komisioni ka përlllogaritur se vlera e investimit rezultoi 9.128.320 lekë ( $436,1 \text{ m}^2 \times 23.070 \text{ lekë/m}^2 \times 90.73\%$ )<sup>6</sup>, e cila, për efekt të analizës financiare, u pasqyrua në vlerën 5.128.320 lekë në fund të vitit 2003 dhe në vlerën 4.000.000 lekë në vitin 2004, referuar deklaramit të subjektit në deklaratën e pasurisë të këtij viti.
41. Subjekti i rivlerësimit në ankim kundërshton vlerën e koston së ndërtimit të përlllogaritur nga Komisioni, pasi, sipas tij, ky i fundit ka marrë të njëjtin çmim bazë referues si për katet e plota, ashtu dhe për bodrumin, që nuk ka të njëjtën bazë materiale dhe kosto si katet e tjera. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të kishte zbritur nga zërat e punimeve pagën e specialistit, të punëtorit, shpenzimet suplementare dhe fitimin, të cilat janë përballuar nga familjarët e tij, elemente këto të paraqitura në raportin e ekspertizës tekniko-ekonomike të ekspertit të licencuar, I. P., që subjekti ka sjellë në përgjigje të rezultateve të hetimit. Sipas këtij raporti, vlera reale e investimit për ndërtimin e banesës është 4.183.176 lekë dhe vjen si rezultat i faktit që: punimet e ndërtimit kanë filluar që në vitin 1997; kostoja e ndërtimit llogaritet mbi bazën e kostove të referuara dhe miratuara nga EKB-ja nga viti 1997 e në vijim, duke përjashtuar disa zëra; kostoja e ndërtimit duhet të llogaritet në raport me strukturën e objektit.
42. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezulton se situata faktike, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, paraqitet si vijon:
- (i) Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme të datës 21.09.2020, subjekti i rivlerësimit figuron pronar i pasurisë me nr. {\*\*\*}, z.k. {\*\*\*}, Tiranë, e llojit “truall”, me sip.  $298,3 \text{ m}^2$ , nga të cilat  $110,3 \text{ m}^2$  ndërtesë. Në kartelë pasqyrohet shënimi “Leje legalizimi nr. {\*\*\*}, datë 24.03.2009, shuma e paguar 240.823 lekë” dhe tek seksioni “Përshkrim i veçantë” pasqyrohet shënimi “Godinë banimi 2 kate + papafingo + bodrum” dhe me aplikimin nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, është bërë rivlerësimi i pasurisë në shumën 36.425.345 lekë.
  - (ii) Subjekti i rivlerësimit është pajisur me lejen e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 24.03.2009, për objektin “godinë banimi 2 kate + papafingo + bodrum” dhe, sipas të dhënave që pasqyrohen në të, rezulton që: (i) sipërfaqja e ndërtimit është  $110,3 \text{ m}^2$  (njolla e ndërtimit); (ii) sipërfaqe totale e ndërtimit për banim është  $436,1 \text{ m}^2$ ; (iii) numri i kateve mbi tokë është 2 kate + papafingo; si dhe (iv) numri i kateve nëntokë është 1 kat.
43. Lidhur me vlerën e investimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, në përgjigje të rezultateve të hetimit akt ekspertizën tekniko-ekonomike, përkatitur nga ing. I. P., në datën

<sup>6</sup> Mesatare e kostove për sipërfaqe ndërtimi në qytetin e Tiranës, konkretisht të koston për vitin 2002 (22.150 lekë sipas udhëzimit nr. 3, datë 16.10.2002), për vitin 2003 (22.615 lekë sipas udhëzimit nr. 1, datë 08.05.2003) dhe për vitin 2004 (24.446 lekë sipas udhëzimit nr. 1, datë 04.03.2004).

15.11.2022, ku paraqitet një kosto totale e objektit në vlerën 4.183.176 lekë, si dhe një preventiv punimesh të datës 01.09.2003, me vlerë 4.147.637 lekë, të firmosur nga sipërmarrësi/inxhinieri A. J.. Nga verifikimet e kryera në aktet e fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstaton se gjatë procedurës për dhënien e lejes së ndërtimit apo për legalizimin e banesës, nuk rezulton që ky preventiv të ketë qenë pjesë e dokumentacionit të administruar nga organet shtetërore përkatëse, si dokumentacion i cili të ketë lidhje me objektin në fjalë. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka depozituar këtë preventiv bashkëlidhur deklaratës *vetting*, apo në përgjigje të pyetësorëve, por e ka paraqitur në Komision vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit. Gjithashtu, nga hetimi administrativ i Komisionit, nuk ka rezultuar asnjë dokumentacion tjetër ligjor që të provojë se sa ka qenë realisht kostoja e ndërtimit të kësaj banese.

44. Për sa parashtron në ankim subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues sjell në vëmendje se vlerësimi i pretendimeve të tij për llogaritjen e koston së ndërtimit duhet bërë në raport me qëndrimin për përcaktimin e periudhës kohore gjatë të cilës është realizuar ndërtimi i banesës, me qëllim përcaktimin e vlerës së ndërtimit, bazuar në përllogaritjen sipas vlerave të EKB-së, referuar çmimeve sipas viteve të ndërtimit. Vetë subjekti i rivlerësimit, në ankim, pranon se përllogaritja e koston duhet të bëhet sipas vlerave të përcaktuara nga EKB-ja, por kundërshton periudhën që ka konsideruar Komisioni, pasi pretendon se ndërtimi është kryer në periudhën 1997-2004 dhe llogaritja e koston duhet të kryhet sipas vlerave të përcaktuara për këto vite. Duke marrë në konsideratë analizën e mësipërme, për shkakun e ankimit për periudhën e ndërtimit të banesës, Kolegji mban të njëjtin qëndrim me Komisionin se punimet për ndërtimin e banesës kanë filluar në vitin 2002 dhe, në kushtet kur nuk mund të përcaktohet saktësisht lloji apo volumi i punimeve, vlera e investimit duhet të llogaritet bazuar në mesataren e koston së ndërtimit për vitet 2002, 2003 dhe 2004, sipas përcaktimeve nga EKB-ja.
45. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, parashtron se Komisioni në llogaritjen e koston së ndërtimit nuk duhej të bazohej mbi një veprim matematikor sipërfaqe ndërtimi në metër katror, shumëzuar me çmimin për njësi, por duhet të bazohej në llogaritjen metrike të të gjithë zërave të punimeve dhe zbërthimin, sipas elementëve të strukturës së objektit, pasi sipërfaqja e marrë për bazë llogaritjeje 436,1 m<sup>2</sup> nuk duhet të ketë të njëjtin çmim referues, por duhet të jetë e ndryshme për katet e plota, për papafingon apo bodrumin, të cilat nuk kanë të njëjtën strukturë ndërtimi, lartësi, volum ndërtimi apo bazë materiale. Për sa i përket këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji në jurisprudencën e tij ka mbajtur qëndrimin se në legjislacionin e zbatueshëm për miratimin e koston mesatare të banesave nga EKB, kjo kosto mesatare ndërtim përcaktohet si vlerë fikse, respektivisht për sipërfaqe ndërtimi apo sipërfaqe shfrytëzimi, pa bërë dallime në llojet e sipërfaqeve sipas funksionit të tyre<sup>7</sup>. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbetet i pabazuar.
46. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, ashtu si dhe në Komision, pretendon se punimet për ndërtimin e banesës janë kryer nga skuadra të ndryshme punëtorësh apo specialistësh ndërtimi (të njohur të familjes), si dhe me kontributin në ndërtim të anëtarëve të familjes, kryesisht djemtë e hallës, dhe se një pjesë e zërave/materialeve të punimeve janë blerë tek të njohurit e tyre për të marrë çmime sa më të leverdishme dhe ekonomike. Sipas subjektit, në vitin 2003, punimet e kryera në banesë dhe blerja e materialeve të ndërtimit nuk ishin likuiduar në vlerën rreth 3.100.000

---

<sup>7</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 15/2019 (JR) dhe nr. 34/2021 (JR).



lekë dhe për këtë qëllim në vitin 2004 është realizuar edhe shitja e apartamentit të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, për të shlyer detyrimet e lindura si më sipërcituar.

47. Në mbështetje të pretendimeve për kontributin e familjarëve në ndërtimin e banesës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në përgjigje të rezultateve të hetimit një deklaratë noteriale të datës 07.11.2022, të dhënë nga kushëriri i tij Sh. T., i cili deklaron se bashkë me dy vëllezërit kanë kontribuar në punimet për ndërtimin e banesës, meqenëse janë specialistë dhe punëtorë ndërtimi. Trupi gjykues çmon se kjo deklaratë noteriale e hartuar pas gati 20 viteve nga kryerja e ndërtimit, mbetet në kuadrin deklarativ, për sa kohë që nuk është e mbështetur në akte të tjera të kohës. Tashmë Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar në mënyrën e vlerësimit dhe marrjes në konsideratë të deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, duke i konsideruar këto akte me vlerë të kufizuar për sa ato kërkojnë të provojnë. Në kushtet kur kontributi i familjarëve në kryerjen e zërave të ndryshëm të punimeve është një kontribut i dhënë në natyrë dhe i pamatshëm, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar kontributin e dhënë, të konvertuar në vlera monetare. Gjithashtu, konstatohet se mbeten të paprovuara me dokumentacion ligjor (fatura, mandate, kontrata etj.), shpenzimet për blerjen e materialeve të ndërtimit, të pretenduara të kryera nga subjekti i rivlerësimit për ndërtimin e banesës. Ndërkohë, trupi gjykues vëren se Komisioni, me një qëndrim garantist, duke marrë në konsideratë në mënyrë hipotetike edhe pretendimet e subjektit në ankim për llogaritjen e kostos së ndërtimit, ka zbritur disa elemente të kostos nga kostoja e ndërtimi, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke zbritur në analizën financiare 9.27% nga kostoja totale e ndërtimit. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se përpjekjet e subjektit të rivlerësimit, për të ulur shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës dhe për t'i paraqitur ato si të kryera në mënyrë vullnetare, mbeten të pambështetura në prova dhe nuk mund të merren në konsideratë dhe të pasqyrohen në analizën financiare lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve financiare për ndërtimin e banesës.
48. Subjekti i rivlerësimit kundërshton dhe qëndrimin e Komisionit, i cili nuk ka marrë në konsideratë raportin e ekspertit të licencuar të sjellë si provë prej tij, me argumentin se një akt ekspertim i përgatitur pas më shumë se 20 vjetësh nga koha e kryerjes së punimeve nga një inxhinier i përzgjedhur nga vetë subjekti dhe i paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit, është një akt jobindës dhe joreferues për llogaritjen e vlerës së ndërtimit. Vlerësimi i Komisionit është kryer nga këshilltarët ekonomikë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, të cilët nuk kanë njohje apo ekspertizë në fushën e vlerësimit në projektim dhe ndërtim, në ndryshim nga një ekspert i licencuar.
49. Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka paraqitur në Komision akt ekspertizën tekniko-ekonomike, të datës 15.11.2022, përgatitur nga inxhinieri I. P., në të cilën paraqitet një kosto totale e objektit në vlerën 4.183.176 lekë. Në këtë akt përshkruhet se punimet për ndërtimin e këtij objekti kanë nisur rreth fundit të vitit 1997 dhe deri në fund të vitit 1999 kanë përfunduar rreth 75-80% të volumeve të përgjithshme të ndërtimit. Godina është përfunduar totalisht dhe është vënë në funksion rreth fundit të vitit 2003, ku ka përfunduar edhe ndërtimi i çatisë, tip papafingo i katit të fundit. Sipas ekspertit, për llogaritjen e vlerës së çdo objekti ndërtimi, duhet të merren për bazë volumet metrike të zërave të punimeve faktike shumëzuar me çmimin për njësi të secilit zë punimesh. Për

përlllogaritjen e vlerës së ndërtimit në këtë akt ekspertimi janë përdorur çmimet për njësi të hartuara/miratuara për vitin 1998 – 1999, nga EKB-ja. Komisioni ka mbajtur qëndrimin se një akt ekspertim i përgatitur pas më shumë se 20 vjetësh nga koha e kryerjes së punimeve nga një inxhinier i përzgjedhur nga vetë subjekti dhe i paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit është një akt jobindës dhe joreferues për llogaritjen e vlerës së ndërtimit.

50. Për sa i përket pretendimit të subjektit se vlerësimi i Komisionit mbi vlerën e investimit është bërë nga këshilltarët ekonomikë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, të cilët nuk kanë ekspertizë të fushës, silltet në vëmendje se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit. Referuar parashikimeve të nenit 23, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, detyra kryesore e këshilltarëve ekonomikë të Njesisë së Shërbimit Ligjor të institucioneve të rivlerësimit është përgatitja e relacionit të çështjes, veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Kjo detyrë ligjore përmbushet nga këshilltarët ekonomikë, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, si dhe në referim të standardeve të vendosura nga Kolegji në drejtim të çështjeve që lidhen me mënyrën e vlerësimit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me ta. Për sa analizuar më sipër, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit, në të gjitha rastet kur subjektet nuk mund të provojnë me dokumentacion justifikues (situacione punimesh, fatura tatimore), koston për ndërtimin e objekteve në pronësi apo posedim të subjekteve të rivlerësimit apo të personave të lidhur me ta, është detyrë e Njesisë së Shërbimit Ligjor që të përlllogarisë vlerën e pasurisë në drejtim të koston së investuar për ndërtimin e saj, sipas çmimeve të miratuara nga EKB-ja, referuar vitit/viteve në të cilat është kryer ndërtimi.
51. Në aktin e ekspertimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, përcaktimi i vlerës së investimit është bërë sipas kostove të EKB-së, për vitet 1998 dhe 1999, ndërkohë që subjekti nuk ka arritur të provojë se ndërtimi është kryer në këto vite dhe ky fakt e bën të diskutueshme vlerën e përlllogaritur nga eksperti. Gjithashtu, sipas aktit të ekspertimit, punimet e ndërtimit janë bërë me kontributin e familjarëve, por pa dhënë një vlerë konkrete të këtij kontributi të zbritshëm nga shpenzimet, të cilin edhe vetë subjekti i rivlerësimit nuk arriti ta provojë me dokumentacion ligjor. Po ashtu, eksperti ka bërë përlllogaritje të ndryshme për sipërfaqet e objektit sipas strukturës së tij. Të gjithë këto elemente kanë sjellë si rezultat një vlerësim të ndryshëm të koston së ndërtimit nga ai i konkluduar nga Komisioni dhe, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën, akti i ekspertimit i sjellë prej tij nuk përbën një dokument me të dhëna relevante për koston e ndërtimit të banesës.
52. Në këto rrethana, bazuar në analizën e mësipërme dhe pamundësinë e subjektit për të provuar me dokumentacion ligjor pretendimet e tij, vlerësohet i drejtë konkluzioni që Komisioni ka dhënë për koston e ndërtimit të banesës, sipas vlerave të përcaktuara prej EKB-së, pasi është një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues, që do të provonte shpenzimet e kryera nga subjekti për ndërtimin e kësaj banese, referimi nga ana e Komisionit në çmimet e përcaktuara në vlerat e kostove të ndërtimit, publikuar nga EKB-ja, si e vetmja referencë ligjore për përcaktimin e çmimeve, është një qëndrim i drejtë, tashmë i konsoliduar edhe nga jurisprudenca e Kolegjit. Referimi në këto kosto ndërtimi të përcaktuara me vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave, është jo vetëm kriter ligjor i drejtë, por do t'i vendoste të gjitha subjektet e rivlerësimit në një trajtim të barabartë në mënyrën e përlllogaritjeve të vlerave

të pasurive të tyre, në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues për vlerën e ndërtimeve të tyre.

53. Në përfundim të arsytimit të mësipërm, trupi gjykues krijon bindjen se ndërtimi i banesës është kryer në vitet 2002–2004 dhe kostoja e ndërtimit të banesës, sipas vlerave të përcaktuara nga EKB-ja për këto vite, sipas përlllogaritjeve të kryera në Kolegj, rezulton të jetë 9.113.639 lekë, e cila, për efekt të analizës financiare, pasqyrohet në vlerën 5.113.639 lekë në fund të vitit 2003 dhe në vlerën 4.000.000 lekë në vitin 2004.

**- Lidhur me burimet për krijimin e pasurisë**

54. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, ka deklaruar se një nga burimet për ndërtimin e banesës në rrugën “{\*\*\*}” ka qenë kontributi në vlerë të papërcaktuar i vëllait të tij B. Sh., si rezultat i emigracionit në Greqi dhe Angli, i cili ka kontribuar gjithashtu edhe në arredimin dhe rregullimin e banesës në Golem, duke u bërë automatikisht bashkëpronar me marrëveshje në këtë apartament, shfrytëzuar bashkërisht sipas nevojave. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera e përgjithshme e kontributit të vëllait, si në ndërtimin e banesës në Tiranë dhe të asaj në Golem, arrin afërsisht në 27.000 euro.
55. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 24.01.2017, të shtetasit B. Sh., i cili deklaron se: *“Z. Kudusi Shahu është vëllai im dhe për shkak të lidhjes familjare kam kontribuar në vite në ndërtimin e banesës në rrugën “{\*\*\*}”, si dhe në blerjen dhe rikonstruksionin e apartamentit të ndodhur në Golem, Durrës [...], në vlerën monetare totale 27.000 euro [...] dhe këtë shumë e kam dhënë për shkak të mundësisë që kam pasur, pasi nga viti 1999 deri në gusht të vitit 2001, kam qenë emigrant në Mbretërinë e Bashkuar”*.
56. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit, në seksionin e deklarimit të detyrimeve ndaj personave juridikë dhe fizikë, ka deklaruar: *“Marrë hua 1.000.000 lekë për ndërtimin e shtëpisë nga B. Sh.”*.
57. Nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit në procesverbalin e datës 01.02.2016, të mbajtur nga ILDKPKI-ja<sup>8</sup>, ku shprehet se: *“Shtëpia është ndërtuar me kursimet nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes dhe më pas nga shitja e apartamentit të përfituar nga EKB-ja në datën 08.10.2004”*, konstatohet se ai nuk i deklaron të ardhurat e vëllait nga emigracioni si një nga burimet e pasurisë banesë. Në pyetësin standard, në përgjigje të pyetjes nr. 1, mbi adresat e banimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të banesës në rrugën “{\*\*\*}” shitjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, kontributin e familjes dhe të ardhurat nga puna në emigracion e vëllait. Po në këtë pyetësor, në përgjigje të pyetjes nr. 4, nëse ka marrë ndonjëherë dhuratë më shumë se 500 euro, subjekti nuk e deklaron shumën e dhënë nga vëllai i tij si dhuratë dhe në përgjigje të pyetjes të pyetjes nr. 9, nëse ka pasur shpenzime më të mëdha se 2.500 euro, subjekti, pasi deklaron ndërtimin e banesës në vitin 2001, nuk deklaron si burim të ardhurat e vëllait, por vetëm kursimet nga paga e tij nga viti 1991-2004, pagën e bashkëshortes nga viti 2004 dhe shitjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, në vlerën 2.000.000 lekë.

---

<sup>8</sup> Dërguar në Komision me shkresën nr.{\*\*\*} prot., datë 08.04.2022.

58. Me anë të pyetësorit nr.1, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të saktësonte vitin kur vëllai i tij i ka falur shumën e dhënë hua, të paraqesë dokumentacion ligjor që konfirmon këtë marrëdhënie juridike, si dhe dokumentacion ligjor justifikues të të ardhurave të realizuara nga shtetasi B. Sh., të cilat kanë shërbyer si burim për shumën 1.000.000 lekë. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se vëllai i tij B. Sh. në fazën e ndërtimit të shtëpisë, por para vitit 2004, i ka dhënë hua shumën 1.000.000 lekë, e cila ka shërbyer për ndërtimin e shtëpisë dhe me kalimin e kohës ai nuk ia ka kërkuar këtë shumë, madje ia ka falur. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ky veprim nuk është pasqyruar me dokumentacion ligjor për shkak të lidhjes familjare. Lidhur me dokumentacionin që provon të ardhurat e shtetasit B. Sh., subjekti ka sqaruar në Komision se po bën përpjekje për të mundur dokumentacionin që konfirmon punësimin dhe të ardhurat e vëllait të tij në shtetin anglez.
59. Në vazhdim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.10.2022, të shtetasit G. A., i cili deklaron se është rezident në Londër, nga viti 1999 dhe se po këtë vit është takuar nëpërmjet rrethit shoqëror me shtetasin B. H. Sh., i cili në atë periudhë ishte pa letra pune për të punuar në Mbretërinë e Bashkuar. Duke qenë se ishte me dokumente angleze, vijon deklaruesi, dhe aktiviteti i tij ka qenë me punë ndërtimi, shtetasi B. Sh. i ka kërkuar letrat e tij të punës për të punuar për një periudhë kohe të pacaktuar. Më tej, vijon deklaruesi, për shkak se rreth vitit 1999 i duhej të shkonte në Greqi, ka pasur mundësi t'i jepte dokumentet e tij të punës, por me kushtin që taksat të paguheshin në emër dhe për llogari të tij. Bashkëlidhur deklaratës noteriale gjendet kopja e pasaportës angleze të shtetasit G. A. dhe dokumenti në gjuhën angleze i lëshuar nga autoriteti i shtetit anglez që vërteton të ardhurat e realizuara dhe taksat e paguara në vitet 2000-2004. Për periudhën 1999-2000 nuk ka të dhëna punësimi për shtetasin G. A., ndërsa për periudhën 2000-2001, të ardhurat kanë qenë në vlerën 7.864 GBP.
60. Komisioni, me rezultatet e hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon të ardhurat e ligjshme të shtetasit B. Sh., në zbatim të pikës 3, të nenit D të Aneks Kushtetutës. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se vlera prej 1.000.000 lekësh ishte në formë huaje nga të ardhurat që i vëllai kishte realizuar në emigracion në Greqi dhe në Mbretërinë e Bashkuar dhe, më pas, ia ka falur atij, si rrjedhojë e deklaratës noteriale nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2016, me anë të së cilës subjekti i ka falur pjesën takuese në apartamentin me sip. 132 m<sup>2</sup>, në Tiranë, të cilën e ka përfituar nga çelja e dëshmisë së trashëgimisë së babait të tij. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se një pjesë të konsiderueshme të shumave monetare vëllai i ka sjellë nëpërmjet Western Union, duke paraqitur disa nga mandatet e dërgesave të parave, dhe se nga ana e tij po vazhdojnë përpjekjet për të marrë informacion nëpërmjet komunikimeve elektronike. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga kryerja e transfertave, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit që në bazë të parashikimeve të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 të pranojë ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme për mosparaqitjen e gjithë mandateve, si dokumente justifikuese për vërtetimin e burimeve të ligjshme të vëllait të tij B. Sh.. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur rezultateve të hetimit dhe një dokument të lëshuar nga *UK Immigration Service*, i përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilin jepen të dhëna për qëndrimin e vëllait të tij në Mbretërinë e Bashkuar për periudhën 1999-2001.

61. Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe të dokumentacionit ligjor provues të paraqitur gjatë hetimit administrativ, për sa u përket të ardhurave të vëllait të tij, të deklaruar se janë fituar nga puna si emigrant në Mbretërinë e Bashkuar, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë faktin e qëndrimit të vëllait në këtë shtet, ndërsa për sa i përket faktit të punësimit në këtë periudhë, ndonëse duket se ky qëndrim mund të ketë shërbyer për të punuar dhe krijuar të ardhura, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, në kuptim të ligjit, marrëdhënien e punës dhe krijimin e të ardhurave në shumën 27.000 euro (ku përfshihet edhe vlera prej 1.000.000 lekësh, objekt analize), si dhe ligjshmërinë e tyre, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
62. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit paraqet të njëjtat argumente si në Komision, duke pretenduar se shuma 1.000.000 lekë është kontribut në formë huaje i vëllait, krijuar nga të ardhurat nga emigracioni në Greqi dhe në Mbretërinë e Bashkuar pa kontratë, vetëm me deklaratë noteriale, dhe se kjo shumë e dhënë fillimisht si hua, më vonë i është falur nga vëllai pas heqjes dorë nga subjekti i rivlerësimit nga pjesa takuese në apartamentin e lënë trashëgim nga babai.
63. Trupi gjykues mori në shqyrtim këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, duke pranuar si të drejtë konkluzionin e Komisionit se vëllai i subjektit të rivlerësimit duhet të konsiderohet si person tjetër i lidhur, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për sa i përket kontributit të tij financiar në ndërtimin e banesës. Në vlerësimin e kontributit të dhënë nga vëllai, si një nga burimet që ka shërbyer për ndërtimin e banesës, trupi gjykues konsideron se rëndësi ka ligjshmëria e të ardhurave nga të cilat ka rrjedhur ky kontribut. Pavarësisht se, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, shuma prej 1.000.000 lekësh në fillim ka qenë hua dhe më pas është falur, trupi gjykues çmon të nënvizojë se në të dy rastet vëllai i subjektit konsiderohet person tjetër i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të vlerës së deklaruar se ka shërbyer për ndërtimin e banesës.
64. Nga aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vëren se ai ka provuar qëndrimin e vëllait në Mbretërinë e Bashkuar për periudhën 1999-2001, sipas dokumentit të lëshuar nga *UK Immigration Service*, por nuk ka arritur të provojë punësimin apo përfitimin e të ardhurave të vëllait në emigracion në këtë periudhë. Dërgesat e shumave monetare nga vëllai nëpërmjet Western Union për periudhën 1999-2001, sipas mandateve të dërgesave të sjella nga subjekti i rivlerësimit në Komision, nuk provojnë burimin e krijimit të këtyre vlerave monetare. Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.10.2022, e shtetasit G. A., sipas së cilës ky shtetas i ka dhënë vëllait të subjektit të rivlerësimit në vitin 1999 dokumentet e tij të punës, me kushtin që taksat të paguheshin në emër dhe për llogari të tij, nuk sjell asnjë të dhënë që të provojë se vëllai i subjektit është punësuar realisht dhe ka përfituar të ardhura në shtetin anglez apo që të këtë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura. Pretendimi i subjektit se këto të ardhura duhet të konsiderohen të ligjshme, për shkak se janë përfituar nga i vëllai në emër të një shtetasi të siguar, nuk vlerësohet si një fakt që konfirmon ligjshmërinë e krijimit të tyre për efekt të analizës financiare, që lidhet me kontrollin e ligjshmërisë së ndërtimit të banesës në vitet 2002-2004.

65. Në përfundim, trupi gjykues çmon se vetëm deklarimi i kontributit financiar të vëllait të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike të vitit 2004, i pashoqëruar me dokumentacion provues, është i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mbi ligjshmërinë e shumës së dhënë hua prej 1.000.000 lekësh.
66. Sa më sipër, mbetet i bazuar konkluzioni i Komisionit se për sa kohë nuk u provua punësimi dhe pagesa e detyrimeve tatimore, të ardhurat e personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në procesin e rivlerësimit kalimtar, në kuptim të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, për të justifikuar kontributin prej 1.000.000 lekësh për krijimin e kësaj pasurie.
67. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, kundërshton dhe analizën financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me kryerjen e investimit për ndërtimin e banesës. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, për periudhën 1993-2003, rezultojnë me një balancë negative në vlerën 6.100.570 lekë për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive dhe kryerjen e investimit në banesë.
68. Subjekti i rivlerësimit, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, pretendon se: (i) duhet të merren në konsideratë edhe të ardhurat e tij që nga viti 1991 dhe jo që nga viti 1993, siç ka vepruar Komisioni, bazuar kjo në publikimet e Bankës së Shqipërisë; (ii) duhet të zvogëlohet vlera e shpenzimeve të jetesës, duke mospërlllogaritur shpenzime për periudhën 1991 – 1992, si dhe të saktësohen shpenzimet për periudhën në vijim, konkretisht për periudhën janar 1993 – shkurt 1995, të përlllogariten në masën 30% të të ardhurave dhe për periudhën mars 1995 – dhjetor 1999, të përlllogariten në masën 40% të të ardhurave; (iii) duhet të përfshihet në analizën financiare mbështetja financiare nga ana e prindërve të subjektit, të cilët në periudhën 1997 – 1998 i kanë kaluar një pjesë të kursimeve të tyre, rreth 5.000 USD, për ta ndihmuar ekonomikisht në përballimin e shpenzimeve për jetesë në kushtet kur subjekti kishte shpenzime lidhur me investimin që po kryente për ndërtimin e shtëpisë; (iv) të mbahet në konsideratë që nga ana e subjektit janë krijuar kursime në monedhën USD në mënyrë periodike, çka afekton pasqyrimin në analizën financiare të vlerës në lekë të pagesës së kështit të parë prej 7.200 USD për truallin, vlerë e cila, sipas subjektit, duhet të jetë 751.200 lekë dhe jo 1.080.000 lekë, siç është përlllogaritur nga Komisioni.
69. Komisioni nuk ka pranuar përfshirjen në analizë të të ardhurave të përfituara nga pagat e viteve 1991-1992, në kushtet e arsyetimit të përdorur nga Kolegji në funksion të një qëndrimi orientues në vendimin nr. 15, datë 18.06.2021. Për më tepër, Komisioni ka çmuar se shuma totale e të ardhurave nga paga për këtë periudhë, prej 20.625 lekësh, është në një masë të tillë që nuk mund ta përmbysë rezultatin përfundimtar të analizës financiare.
70. Referuar qëndrimit të Kolegjit në vendimin nr. 15/2021, periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend, që përkon me vitet 1991-1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe

ekonomike në vend, që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Sipas këtij qëndrimi të Kolegjit, bëhet fjalë për kurse të mundshme të pretenduara se janë krijuar për vitet 1991 dhe 1992. Por, në rastin e tij, subjekti i rivlerësimit kërkon që në analizë të përfshihen të ardhurat nga paga për këto vite dhe jo kursimet, prandaj referimi i Komisionit në jurisprudencën e Kolegjit nuk është i saktë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vëren se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga pagat për periudhën 1991–1992, pavarësisht vlerës së vogël prej 20.625 lekësh, që nuk mund ta ndryshojë rezultatin përfundimtar.

71. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtroi se shpenzimet për periudhën 1993 – 1995 duhet të llogariten në masën 30% të të ardhurave, në ndryshim nga Komisioni, i cili i ka llogaritur në masën 40%. Sipas subjektit të rivlerësimit, shpenzimet e tij kanë qenë më të ulëta për shkak të statusit të tij si ushtarak dhe kushteve të banimit.
72. Komisioni, pasi ka analizuar të ardhurat nga paga e subjektit, në kuadër të arsyetimit të përdorur nga Kolegji në vendimin nr. 15/2021, ka konstatuar se shuma vjetore e të ardhurave nga pagat e subjektit është dukshëm më e lartë se 800 USD, si dhe ka përllogaritur në analizën financiare shpenzimet e jetesës në një shumë prej 830.753 lekësh për periudhën 1993 – 1999, në masën 40% të të ardhurave.
73. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji, në vendime të mëparshme të tij<sup>9</sup>, mbështetur në një analizë logjike dhe në të dhënat e Raportit të vitit 1995 të Bankës së Shqipërisë, ka konstatuar se raporti i pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve me ato të funksionarëve të tjerë të sektorit publik qëndronte përafërsisht në raportin rreth 30% më të larta. Në këto kushte, duke marrë parasysh këtë raport, krahasuar me informacionin që jep Banka e Shqipërisë në raportin e cituar më lart, Kolegji ka vlerësuar se në rastin e analizës financiare, në të cilat figurojnë të ardhura të siguruara nga puna e gjyqtarëve apo prokurorëve, shpenzimet e jetesës duhet të llogariten në masën 30% të të ardhurave, që përfron me masën e shpenzimeve për jetesë në raportin 66% të të ardhurave që i përkasin pagave mesatare të gjithë sistemit të pagave. Logjika që mbështet këtë konkluzion vjen si pasojë e arsyetimit ligjor se standardi për shpenzimet e jetesës duhet të jetë i njëjtë për shtetasit dhe subjektet e rivlerësimit, për sa kohë që nuk rezultojnë të dhëna zyrtare që do të përcaktonin ndryshe. Në këto kushte, individët që fitojnë më shumë të ardhura, duke ruajtur të njëjtin standard për vlerën e shpenzimeve të llogaritura, duhet të kenë potencialisht më shumë mundësi kursimi. Për rrjedhojë, në vijim të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit konsiderohet i bazuar dhe është reflektuar në analizën financiare, duke u përllogaritur shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999 në masën 30% të të ardhurave.
74. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ka bërë në mënyrë graduale konvertimin e vlerës 7.200 USD, përkatësisht në vitet 1995 (2.500 USD), 1996 (1.700 USD), 1997 (1.000 USD) dhe në vitin 1998 (2.000 USD), nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit rezulton se:

---

<sup>9</sup> Shih vendimin nr. 25/2021 (JR) të Kolegjit.

74.1. Nga dokumentacioni i administruar në Komision nga AShK-ja, Tirana Veri<sup>10</sup>, rezulton se sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.02.2001, shtetasit O. K. etj., janë pronarë të një sipërfaqe truallit të lirë prej 2.996,5 m<sup>2</sup> dhe nga kjo sipërfaqe i kanë shitur blerësit Kudusi Shahu truallin me sipërfaqe 302,6 m<sup>2</sup> me çmimin e shitjes prej 1.200.000 lekësh, dhe se kjo shumë është likuiduar nga palët jashtë zyrës noteriale.

74.2. Komisioni, me anë të pyetësorit nr.1, i ka kërkuar subjektit të saktësonte vitin e blerjes së truallit, si dhe të paraqesë dokumentacionin provues. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka filluar likuidimin e çmimit të blerjes së truallit në mënyrë të pjesshme dhe likuidimi total ka përfunduar në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*}., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.02.2001. Gjithashtu, ai ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale nr. 3840 rep., datë 16.10.2000, në të cilën shtetasit M. Ç. dhe N. K. kanë deklaruar se si përfaqësues të bashkëpronarëve në datën 16.10.2000 morën nga z. Kudusi Shahu shumën prej 7.200 USD, në lidhje me blerjen nga ana e këtij të fundit të një truallit, i cili ndodhet në Tiranë, rruga “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” me sip. 302,6 m<sup>2</sup> dhe diferencën prej 120.000 lekësh, z. Kudusi Shahu, do ta likuidojë me lidhjen e kontratës. Kjo deklaratë noteriale është nënshkruar dhe nga subjekti i rivlerësimit.

74.3. Në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se *me dakordësinë time dhe të pronarëve ka filluar likuidimi i truallit në mënyrë të pjesshme, e cila ka përfunduar likuiduar total në momentin e kontratës përfundimtare, me kontratën nr. {\*\*\*}, datë 19.02.2001.*

74.4. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti, në sqarimet lidhur me burimin e të ardhurave për pasurinë e llojit “truall dhe ndërtesë” me sipërfaqe 298,3 m<sup>2</sup>, nga të cilat 110,3 m<sup>2</sup> ndërtesë, ka sqaruar se: *Arsyeja që kam kryer një pagesë në vitin 2000, edhe pse nuk kisha lidhur kontratën e shitjes, ka qënë pikërisht, sepse e kisha përmbyllur negociatën me palën shitëse pronare të truallit, kisha marrë truallin në posedim, pasi kisha filluar punimet, nëpërmjet kësaj pagese paraprake, iu jepja garanci palëve shitëse që interesi im për blerjen e pronës ishte real dhe angazhohesha të shlyeja një pjesë të çmimit të blerjes, sikurse dakortësuar më herët.*

75. Nga aktet e mësipërme dhe nga vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se pagesat për blerjen e truallit janë bërë në vitet 2000 dhe 2001, dhe nuk ka asnjë të dhënë për sa pretendon subjekti se ka bërë në mënyrë graduale konvertimin e vlerës së pagesës së parë prej 7.200 USD në vitet 1995,1996, 1997 dhe në vitin 1998. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në dokumentin ligjor të administruar, kontratën e shitblerjes së truallit nr. {\*\*\*} rep., datë 19.02.2001 dhe në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 16.10.2000, konkludon se shuma 7.200 USD është paguar në vitin 2000 dhe konvertimi i kësaj shume për efekt të analizës financiare duhet të bëhet sipas kursit të këmbimit të këtij viti, në ndryshim nga Komisioni i cili ka konsideruar atë të vitit 2001, sipas datës së kontratës. Sipas kursit historik të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 16.10.2000 (data e deklaratës noteriale), kjo shumë e konvertuar rezulton të jetë 1.075.680 lekë.

---

<sup>10</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 07.10.2020.



76. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, pretendon se duhet të përfshihet në analizën financiare dhe mbështetja financiare nga ana e prindërve të tij, të cilët në periudhën 1997–1998 i kanë kaluar një pjesë të kursimeve të tyre, rreth 5.000 USD, për ta ndihmuar ekonomikisht në përballimin e shpenzimeve për jetesë në kushtet kur subjekti kishte shpenzime lidhur me investimin që po kryente për ndërtimin e shtëpisë. Trupi gjykues vëren se këtë pretendim subjekti i rivlerësimit e ka ngritur në Komision, vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit, ndërkohë që ka pasur detyrimin për deklarimin e kësaj shume në deklaratën *vetting* si një nga të ardhurat që, sipas tij, ka shërbyer për kryerjen e investimit. Gjithashtu, rezulton se dhe në pyetësin standard, në përgjigje të pyetjes nr. 4, nëse *keni marrë ndonjëherë ndonjë dhuratë me vlerë më të lartë se 500 euro, apo a ju ka financuar ndokush ndonjëherë shpenzimet në këtë shumë, apo në shumë më të lartë se kjo*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë shumë si ndihmë ekonomike nga prindërit. Edhe nga verifikimi i akteve të administruara në dosjet e Komisionit nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë sjellë ndonjë provë/akt për sa pretendon. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbetet i paprovuar.
77. Në Kolegj, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, është kryer analiza financiare për të ardhurat e shpenzimet e subjekti të rivlerësimit, në funksion të verifikimit të mundësisë së tij dhe të personit tjetër të lidhur me të, vëllait, për të përballuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e pasurisë shtëpi banimi, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, duke përdorur në këtë analizë edhe konkluzionet e renditura më lart, për sa i takon: (a) kohës së ndërtimit të objektit në vitet 2002-2004; (b) vlerës së objektit prej 9.113.639 lekësh, sipas kostos mesatare të ndërtimit përcaktuar prej EKB-së; (c) burimeve të ligjshme të pranura në këtë arsyetim se janë përdorur për ndërtimin e tij, sipas analizës më sipër. Referuar sa më sipër, sipas analizës financiare tërësore të investimit të kryer në banesën në rrugën “{\*\*\*}”, për të gjithë burimet, subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 6.039.210<sup>11</sup> lekë gjatë periudhës 1993 – 2003, për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve, blerjen e pasurive dhe kryerjen e investimit në banesën objekt analize. Kolegji ka kryer dhe kontrollin e analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2004, nga e cila ka rezultuar se gjatë vitit 2004, subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi për kryerjen e shpenzimeve dhe të investimit në banesën objekt analize në një vlerë të paktën sa ajo e rezultuar në analizën e Komisionit prej 698.124 lekësh.
78. Në konkluzion, për pasurinë banesë 2 kate, në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, trupi gjykues, pasi analizoi aktet dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, çmon se ai nuk arriti të provojë që punimet e ndërtimit të banesës kanë filluar në vitin 1997 dhe mbetet i bazuar konkluzioni i Komisionit se ndërtimi ka filluar në vitin 2002. Për rrjedhojë, duke qenë edhe në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues që do të provonte shpenzimet e kryera nga subjekti për ndërtimin e banesës, kostoja e ndërtimit të saj duhet të llogaritet duke u bazuar në mesataren e kostos së ndërtimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave për vitet 2002, 2003 dhe 2004. Lidhur me burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, vëllait të

<sup>11</sup> Me një ndryshim të vogël nga vlera e Komisionit prej 6.100.570 lekësh, për shkak të llogaritjes së shpenzimeve të jetesës në masën 30%.

tij, për të justifikuar kontributin prej 1.000.000 lekësh për ndërtimin e banesës. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën vetting, duke mosdeklaruar kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit, si dhe rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për ndërtimin e banesës deri në vitin 2003 dhe gjithashtu për kryerjen e investimeve në këtë banesë gjatë vitit 2004, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

**- Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, në Tiranë**

79. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë: “Apartament banimi me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup> në rrugën “{\*\*\*}” (kontratë shitje me rezervë nr. {\*\*\*}, datë 08.08.2006) (kontratë nr. {\*\*\*}/rep/kol., datë 15.02.2016. C.p. zk {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}). Vlera: 50.000 euro. Në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabarta”. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: “Kursimet nga pagat deri në vitin 2006, si dhe pakësim gjendje 800.000 lekë dhe 600.000 lekë kursime vjetore, pjesa tjetër marrë hua pa interes nga një i njohuri im në shumën 5.000.000 lekë”. Në seksionin e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar: “[...] marrë hua pa interes nga F. K., i cili ushtron aktivitet tregtar në tregun Çam, {\*\*\*} ShPK në shumën 5.000.000 lekë (pa kontratë, me deklaratë)”.
80. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sip. 60 m<sup>2</sup> rruga “{\*\*\*}”, blerë në vitin 2006” dhe si burim deklaron: “Pakësim 800.000 lekë të deklaruar në deklaratën e mëparshme, 600.000 kursime vjetore, pjesa tjetër marrë borxh të afërmeve”, në shumën 50.000 euro, me pjesë 50%. Në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: “Marrje borxh për blerje apartamenti një të afërmi tim në vitin 2006 pa interesa në shumën 5.000.000 lekë” dhe në seksionin e të dhënave konfidenciale ka deklaruar: “Marrë borxh për blerje apartamenti në vitin 2006, F. K. në shumën 5.000.000 lekë”.
81. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se në pyetësin standard<sup>12</sup> subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Në vitin 2006 blerje apartamenti banimi, kontratë me rezervë me sip. 60 m<sup>2</sup>, rruga “{\*\*\*}”, me vlerë 50.000 euro. Burimi i financimit janë kursimet nga pagat deri në vitin 2006, si dhe pakësim gjendje 800.000 lekë dhe 600.000 kursime vjetore. Pjesa tjetër marrë hua pa interes nga F. K. në shumën 5.000.000 lekë”. Të njëjtin deklarim ka bërë subjekti i rivlerësimit dhe përpara ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të datës 01.02.2016<sup>13</sup>.
82. Nga dokumentacioni i administruar në Komision nga sistemi elektronik i ASHK-së, Tirana Veri<sup>14</sup> dhe nga notere M. D.<sup>15</sup>, si dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK<sup>16</sup>, rezulton se ndërmjet kësaj shoqërie dhe subjektit është lidhur kontrata e shitjes me rezervë nr. {\*\*\*} prot., datë 08.08.2006, me objekt shitjen e apartamentit tip 6 (kulla 4), me sipërfaqe ndërtimi në total 73

<sup>12</sup> E-mail datë 27.07.2020.

<sup>13</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 08.04.2022.

<sup>14</sup> Shkresa datë 21.04.2022.

<sup>15</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 11.04.2022.

<sup>16</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 26.04.2022

m<sup>2</sup>, i përbërë nga 67 m<sup>2</sup> sipërfaqe apartamenti plus 6 m<sup>2</sup> sipërfaqe në pjesën e përbashkët të shkallëve. Në kontratë parashikohet se palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes të jetë 50.500 euro. Për sa u përket termave të pagesës, në këtë kontratë është përcaktuar se: (i) blerësi ka paguar vlerën 25.000 euro me nënshkrimin e kësaj kontrate; dhe (ii) blerësi do të paguajë vlerën prej 25.500 euro brenda datës 15.09.2006.

83. Po nga aktet rezulton se ndërmjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe subjektit të rivlerësimit është lidhur kontrata e shitjes nr. {\*\*\*}, datë 15.02.2016, me objekt “Kalimi i pronësisë së apartamentit me nr. pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup>, z.k. {\*\*\*}, Tiranë, kundrejt çmimit 50.500 euro”. Në kontratë pasqyrohet se blerësi e ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes objekt kontrate, sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. {\*\*\*} prot., datë 08.08.2006.
84. Lidhur me një nga burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e këtij apartamenti, Komisioni, në vendim, ka konkluduar se personi tjetër i lidhur, shtetasi F. K. ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huasë në vlerën 5.000.000 lekë. Ndërsa, për burimet e tjera për blerjen e apartamentit, kursimet nga pagat deri në vitin 2006, pakësimin e gjendjes 800.000 lekë, si dhe 600.000 lekë kursime vjetore, Komisioni, nisur nga deklarimet e subjekti të rivlerësimit, ka kryer analizën financiare deri në datën 15.09.2006, duke u bazuar në termat e pagesës së kontratës së datës 08.08.2006, sipas së cilës në ditën e nënshkrimit të saj në datën 08.08.2006, blerësi/subjekti ka paguar vlerën 25.000 euro dhe në datën 15.09.2006 ka paguar pjesën tjetër prej 25. 500 eurosh.
85. **Lidhur me pakësimin e gjendjes cash në vlerën 800.000 lekë**, në vitin 2006, Komisioni, pasi ka analizuar deklarimet e subjektit të rivlerësimit për gjendjen *cash* në vite, ka konstatuar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* jashtë sistemit bankar. Në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se i është referuar deklaratës së vitit 2003, në të cilën është deklaruar gjendja *cash* në shumën 8.000 USD. Kjo shumë, deklaroi subjekti, është konvertuar me kursin 1 USD=100 lekë, duke u përfituar shuma 800.000 lekë.
86. Komisioni ka konstatuar se subjekti është kontradiktor në deklarimet e tij, pasi nga analizimi i deklaratave periodike vjetore për vitet 2003 – 2005 rezulton se likuiditetet *cash* në vlerën 8.000 USD, të deklaruara në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, janë pakësuar 1 vit më vonë, pra, në vitin 2004. Sipas deklarimit në DPV-në 2004, vlera prej 8.000 USD është përdorur për ndërtimin e banesës 2 kate + papafingo, në Tiranë. Për rrjedhojë, vlera 8.000 USD nuk mund të ketë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë dhe, për këtë arsye, nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit.
87. Ndërsa, *për kursimet vjetore prej 600.000 lekësh*, Komisioni, pasi kreu analizën financiare për të verifikuar nëse subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi për të kursyer deri në datën

15.09.2006, shumën 373.120 lekë ( $6.173.120 \text{ lekë}^{17} - 5.000.000 \text{ lekë} - 800.000 \text{ lekë} = 373.120 \text{ lekë}$ ), ka konkluduar në një balancë pozitive në vlerën 188.467 lekë.

88. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 800.000 lekë, në datën 15.09.2006, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe  $60 \text{ m}^2$ , në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
89. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, kundërshton konkluzionin e Komisionit duke pretenduar se diferenca negative prej 800.000 lekësh nuk qëndron dhe se në deklaratimet e tij ka një lapsus, pasi ai ka deklaruar që si burim për apartamentin ka qenë shuma prej 8.000 USD, e cila në fakt është përdorur për ndërtimin e banesës dykatëshe në rrugën “{\*\*\*}”. Lidhur me këtë pretendim, nga verifikimi i akteve, trupi gjykues konstaton se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar se një nga burimet për blerjen e apartamentit ka qenë dhe pakësimi i gjendjes *cash* në vlerën 800.000 lekë. Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit ka bërë dhe në deklaratën periodike të vitit 2006, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 01.02.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 7, si dhe në përgjigjet e pyetësorit standard. Gjithashtu, në pyetësorin nr.1, në përgjigje të pyetjes lidhur me apartamentin  $60 \text{ m}^2$ , *shpjegoni se cilave likuiditete u referoheni, duke qenë se në DIPP-në e vitit 2005 nuk rezulton të keni deklaruar kursime cash jashtë sistemit bankar*, subjekti ka sqaruar se i referohet deklaratës së vitit 2003, ku është deklaruar gjendja *cash* në shumën 8.000 USD. Kjo shumë, deklaroi subjekti, është konvertuar në lekë në periudhën prill-gusht 2006, me kursin  $1 \text{ USD} = 100 \text{ lekë}$ , duke u përfutur shuma 800.000 lekë.
90. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore rezulton se, ashtu si ka konstatuar dhe Komisioni, likuiditetet *cash* në vlerën 8.000 USD, të deklaruara në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, janë pakësuar 1 vit më vonë, pra, në vitin 2004, për ndërtimin e banesës 2 kate + papafingo, në Tiranë dhe nuk mund të kenë shërbyer për blerjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendimin se ky deklaram është një lapsus i tij vetëm në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit. Trupi gjykues çmon se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, për një lapsus në deklaramin e pakësimit të gjendjes *cash*, mbetet në nivel deklarativ, në kushtet kur nuk provohet pakësimi i gjendjes *cash* në vlerën 800.000 lekë, si dhe bazuar në konstatimin se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar qëndrimin e tij vetëm në momentin e njohjes me rezultatet e hetimit, në mospërputhje me deklaramet e tij të mëparshme në deklaratën *vetting*, atë periodike vjetore, si dhe me shpjegimet e tij në Komision dhe në deklaramet në ILDKPKI. Për rrjedhojë, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë një nga burimet e deklaruara për blerjen e apartamentit.
91. Subjekti, gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në ankim e në parashtrimet e paraqitura pranë Kolegjit, kundërshton dhe konkluzionin e Komisionit për mundësinë e kursimeve në vitin 2006 në shumën 600.000 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza e kryer

---

<sup>17</sup> Ekuivalenti në lekë i blerjes së apartamentit, sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 26.04.2022, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. E njëjta vlerë rezulton edhe sipas kursit zyrtar të këmbimit të datës 08.08.2006,  $1 \text{ euro} = 122,24 \text{ lekë}$ .

nga Komisioni nuk ka një logjikë ekonomike, pasi në këtë analizë rezulton një gjendje pozitive në shumën 188.467 lekë, e cila duke qenë e krijuar në mes të vitit nuk mund të mos përfshihet si gjendje *cash* e kursyer deri në atë periudhë, dhe nëse do të përfshihej kjo diferencë pozitive gjendja *cash* e kursyer deri në datën 15.09.2006 do të ishte 561.587 lekë (373.120 +188.467 lekë). Analiza e vitit 2006, duke zbritur shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, për shkak se ato janë përballuar nga njerëzit e tij, si dhe duke përfshirë edhe të ardhurat e bashkëshortes, për të cilat janë paguar tatimet, paraqitet me balancë pozitive në vlerën 101.719 lekë.

92. Për sa i përket pretendimit për reduktimin e shpenzimeve për udhëtime në vlerën 8.659 lekë, nga verifikimi i deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, rezulton se ai nuk ka kryer asnjë deklarambi mbulimin e shpenzimeve nga të afërmit e tij në deklaratat periodike vjetore, konkretisht në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision disa deklarata noteriale nga të afërm të tij për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të tij dhe familjarëve, për udhëtime të kryera në vite, por konstatohet se asnjë nga këto deklarata nuk përfshin periudhën 01.01.2006 – 15.09.2006, që është objekt analize. Trupi gjykues vëren se sipas deklarimeve dhe akteve të sipërcituara, mbetet i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit në vlerën 8.659 lekë, në analizën financiare për mundësinë e pagesës së kësteve të apartamentit. Për këtë arsye, është i bazuar qëndrimi i Komisionit, i cili, për rastet e qëndrimit pranë të afërme/miqve, për të cilat nuk është paraqitur dokumentacion, ku përfshihen dhe udhëtimet për periudhën 01.01.2006 – 15.09.2006, shpenzimet e qëndrimit/udhëtimit i ka përlllogaritur sipas jurisprudencës së Kolegjit, referuar vendimit nr. 11-2019 (JR) të tij.
93. Për sa u përket pretendimeve për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortes nga dhënia e mësimi të gjuhës angleze, me kurse private në banesë, trupi gjykues vëren se ky pretendim paraqitet nga subjekti i rivlerësimit, jo vetëm në lidhje me shkakun e ankimit për pasurinë apartament 60 m<sup>2</sup> të ndodhur në Tiranë, por edhe në vijim të ankimit të tij, për pasurinë apartament 95 m<sup>2</sup>, në Golem. Prandaj, vlerësimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave do të reflektohet për të gjithë pasuritë ku ai pretendon se të ardhurat e bashkëshortes nga mësimdhënia janë një nga burimet për krijimin e pasurive.
94. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në Komision rezulton se:
- 94.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes, e kurseve të gjuhës angleze, në banesë, nga viti 2006 – 2016, në shumën 3.000.000 lekë.
- 94.2. Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes, kurse anglisht, në vlerën 450.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia dhe në deklaratat periodike në vazhdim, deri në vitin 2015<sup>18</sup>.

---

<sup>18</sup> Në DPV/2007, të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes nga kurset e gjuhës angleze, si dhe qiraja e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, me vlerë 600.000 lekë; në DPV/2008, të ardhura nga kurset e gjuhës angleze në

94.3. Në procesverbalin e datës 01.02.2016, të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se *kurset janë kryer në ambientet e shtëpisë së banesës sime private, si rrjedhim nuk është mbajtur dokumentacion lidhur me këtë fakt.*

94.4. Nga informacioni i administruar me kërkesë të Komisionit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.08.2020 dhe nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.07.2020, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, shtetasja E. Sh., nuk ka aktivitet privat të regjistruar në emrin e saj.

94.5. Në pyetësin nr. 1, në përgjigje të pyetjes nëse janë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura të deklaruara, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se bashkëshortja nuk ka paguar tatim mbi të ardhurat e realizuara dhe, për këtë, mori masa duke kryer deklarimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi nëpërmjet deklarimit në DIVA-n e vitit 2019, duke paguar dhe detyrimin tatimor të lindur. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës urdhërpagesën e formularit të tatimit mbi të ardhurat në emër të znj. E. Sh., për periudhën janar - dhjetor 2019, vlerën 495.000 lekë, si dhe dokumentin bankar për pagesën e kësaj vlere në datën 06.07.2022.

95. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të ardhurat e përfituara nga mësimdhënia e bashkëshortes, në vlerën 3.000.000 lekë, si dhe dokumentacioni ligjor për pagimin brenda afatit ligjor të detyrimeve tatimore për vitet 2006 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka bërë deklaratimet e këtyre të ardhurave përgjatë viteve në ILDKPKI, si dhe ka paguar tatimin mbi këto të ardhura. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se bashkëshortja e tij në dhënien e kurseve të gjuhës angleze nuk kishte detyrim të lidhte kontratë dhe as të lëshonte faturë tatimore dhe ligji i aplikueshëm i kohës nuk ka të parashikuar detyrim ligjor që në këto raste duhet ta ushtronte aktivitetin në një nga format juridike apo të pajisej me NIPT. Sipas tij, bashkëshortja e tij ka realizuar të ardhura minimale mujore dhe, për pasojë, duhet të merren në konsideratë.
96. Komisioni ka arsyetuar në vendim se, pavarësisht se ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 parashikon se deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë në ILDKPKI mund të përdoren si provë nga organet e rivlerësimit, këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për verifikimin dhe vlerësimin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, por formularët e deklarimit të pasurive dhe të burimit të krijimit të tyre i nënshtrohen kontrollit, ndaj dhe nuk përbëjnë akt zyrtar, në kuptim të fuqisë provuese të parashikuar nga neni 253 i Kodit të Procedurës Civile. Komisioni, duke konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokument apo provë nga ato që parashikohen në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar ushtrimin e aktivitetit të mësimdhënies nga bashkëshortja e tij, ka konkluduar se deklarimi i subjektit për realizimin e të ardhurave nga mësimdhënia e bashkëshortes mbetet në nivel deklarativ. Për sa i përket pagesës së mëvonshme të detyrimeve tatimore, Komisioni ka konstatuar se shlyerja me vonesë e detyrimeve tatimore për vitet 2006 – 2016, gjatë procesit të hetimit administrativ, është bërë

---

*banesë me vlerë 600.000 lekë; në DIPP-të e viteve 2009, 2010 dhe 2011 ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes (kurse të gjuhës angleze), me vlerë 250.000 lekë për secilin vit; në DPV/2012 nuk ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia; në DPV/2013, të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes (kurse të gjuhës angleze), me vlerë 300.000 lekë (muaj); në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015, të ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes (kurse të gjuhës angleze), me vlerë 300.000 lekë.*

për t'i shërbyer procesit të rivlerësimit dhe nuk e shëron paligjshmërinë e këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit.

97. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim si dhe të qëndrimit të Komisionit, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin orientues të Kolegjit në vendimin e tij nr.15/2021, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara. Kolegji ka çmuar se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit, duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t'u arritur.
98. Në rastin konkret, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e realizuara në vite nga bashkëshortja, pasi siç e ka argumentuar dhe vetë gjatë hetimit administrativ në Komision, *bashkëshortja e tij në dhënien e kurseve të gjuhës angleze nuk kishte detyrim të lidhte kontratë dhe as të lëshonte faturë tatimore dhe ligji i aplikueshëm i kohës nuk ka të parashikuar detyrim ligjor që në këto raste duhet ta ushtronte aktivitetin në një nga format juridike apo të pajisej me NIPT dhe [...] se nuk është mbajtur dokumentacion lidhur me këtë fakt.*
99. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues për ushtrimin e aktivitetit të mësimdhënies nga bashkëshortja e tij dhe realizimin e të ardhurave, pavarësisht deklaramentit të tyre në deklaratat periodike vjetore, nisur nga qëndrimi orientues i Kolegjit *se duhet që të provohet bindshëm vetëekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera*, trupi gjykues çmon se është i bazuar qëndrimi i Komisionit se pagesa me vonesë e detyrimeve tatimore nuk ka efekt në drejtim të provueshmërisë së ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, të cilat nuk mund të merren në konsideratë në analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit.
100. Lidhur me referimin që bën subjekti i rivlerësimit në praktikën dhe trajtimin nga Komisioni në çështje të tjera të pagesës me vonesë të detyrimeve tatimore, sillet në vëmendje qëndrimi i Kolegjit se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Kolegji, brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese, shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera për subjekte të tjera rivlerësimi.

101. Sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat nga mësimdhënia e bashkëshortes, në vlerën 3.000.000 lekë, dhe as justifikoi në kuptim të arsyetimit orientues të vendimit nr. 15/2021, të Kolegjit, mospagesën në kohë të detyrimeve tatimore në kuptim të ligjit, këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit.
102. Në konkluzion të sa më sipër, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, blerë në datën 15.09.2006, trupi gjykues vlerëson se nuk provohet bindshëm, me dokumentacion justifikues ligjor të kohës, ekzistenca e të ardhurave të bashkëshortes nga kurset private të mësimdhënies, dhe, në këto kushte, këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit. Për sa i përket burimit tjetër, pakësimit të gjendjes *cash* në vlerën 800.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting* nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, pas verifikimit të deklarimeve në deklaratat periodike vjetore dhe gjatë procesit të rivlerësimit, çmon se vlera 800.000 lekë nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi është deklaruar edhe si burim për krijimin e pasurisë banesë në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 800.000 lekë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**- Për pasurinë apartament me sip. 95 m<sup>2</sup>, në Golem, Kavajë, me vlerë 57.000 euro**

103. Për pasurinë në pronësi apartament, me sip. 95 m<sup>2</sup>, në Golem, Kavajë, subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, pretendon përfshirjen në analizën financiare për këtë pasuri të të ardhurave të bashkëshortes nga kurset private të mësimdhënies, të kontributit të vëllait të tij nga të ardhurat nga emigracioni, reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit, si dhe përfshirjen në analizën e vitit 2011 të një kontributi prej 5.000 eurosh, që pretendon se gjyshërit i kanë dhënë djalit të tij për blerjen e garazhit, që është përdorur nga subjekti në këtë vit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se shuma 30.000 euro e marrë hua nga shtetasi B. H. është përdorur për të kryer pagesat për apartamentin, konkretisht në vlerat 10.500 euro për vitin 2009, 10.500 euro për vitin 2010 dhe 9.000 euro për vitin 2011.
104. Lidhur me këtë pasuri, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është konkluduar se: *Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/vëllait për të justifikuar kontributin prej 2.703.590 lekësh për krijimin e kësaj pasurie. [...] Për sa i përket huasë nga shtetasi B. H. në shumën 30.000 euro, fillimisht Komisioni çmon se nuk mund të pranohet shpjegimi i subjektit se shuma e dhënë hua ka qenë kontribut i gjithë familjes H., pasi ky pretendim është ngritur për herë të parë pas kalimit të barrës së provës, ndërkohë që subjekti i kishte të gjitha mundësitë ta sqaronte këtë situatë në DIPP-në vjetore përkatëse apo në deklaratën vetting. Po kështu, vlerësohet si i pabazuar edhe pretendimi i subjektit për shpërndarjen e kësaj huaje sipas viteve kur janë kryer pagesat për apartamentin, pasi kjo hua është deklaruar vetëm në DIPP/2009. Nëse kjo hua do të ishte përdorur sipas mënyrës së shpjeguar nga subjekti në prapësime, fillimisht ajo do të duhej të ishte deklaruar si shtesë likuiditetesh cash në DIPP/2009 e më tej, duhet të ishte deklaruar pakësimi i tyre në DIPP-të vijuese, kjo bazuar në legjislacionin në fuqi. [...]subjekti i*



*rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/shtetasit B. H., për të justifikuar huan në vlerën 30.000 euro, të deklaruar të përdorur për krijimin e kësaj pasurie. [...] Po kështu, pretendimet lidhur me pasqyrimin e të ardhurave të bashkëshortes nga kurset private të mësimdhënies dhe të ardhurave nga qiraja, si dhe lidhur me reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit, u konsideruan të pabazuara dhe nuk u paraqitën në analizën financiare.[...] Për sa i përket pretendimit të subjektit se në vitin 2011 është përdorur shuma 5.000 euro e kontributit të gjyshërve dhënë djalit të subjektit për blerjen e garazhit, Komisioni e gjen atë të pabazuar, në kushtet që subjekti nuk e ka deklaruar këtë kontribut as në DIPP/2011 dhe as në deklaratën vetting si burim për blerjen e kësaj pasurie.*

105. Në përfundim, Komisioni, duke analizuar burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, për kryerjen e shpenzimeve, shlyerjen e detyrimeve dhe shtesën e kursimeve, me një balancë negative prej 9.558.467 lekësh për vitet 2009, 2010 dhe 2011 (vitet gjatë të cilëve janë kryer pagesat për këtë apartament), duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
106. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit, referuar qëndrimit të Komisionit dhe akteve në fashikull, lidhur me shkaqet e ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues analizon si në vijim:
107. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sipërfaqe 95m<sup>2</sup> në Golem, Kavajë (kontratë nr. {\*\*\*}/rep/kol., datë 29.05.2009), (kontratë nr. {\*\*\*}, datë 11.02.2011. Certifikatë pronësie z.k. {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}). Vlera: 57.000 euro”, zotëron 50%. Si burim krijimi për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar: “Kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe marrje huaje, pa interes, nga i afërmi i tij në shumën 30.000 euro. Vazhdon detyrimi i mbartur në shumën 10.000 euro”. Në seksionin “Detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar: “Marrë hua kushëririt B. Sh. H. për shlyerje apartamenti në Golem, në shumën 30.000 euro”. Në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, pasi deklaroi kontributin e vëllait të tij B. Sh. në ndërtimin e banesës në rrugën “{\*\*\*}”, si rezultat i emigracionit në Greqi dhe Angli (pa kontratë me deklaratë), subjekti ka deklaruar se: “[...] vëllai ka kontribuar dhe në arredimin dhe rregullimin e banesës në Golem, duke u bërë automatikisht bashkëpronar me marrëveshje në këtë apartament, duke e shfrytëzuar bashkërisht sipas nevojave. Vlera e përgjithshme e gjithë kontributit si në ndërtimin e banesës sipërcituar në Tiranë dhe asaj në Golem arrin afërsisht vlerën 27.000 euro”.
108. Lidhur me marrëdhënien e huasë ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit B. H., së pari, trupi gjykues e gjen me vend të përcaktojë se deklarimi i kësaj marrëdhënieje prej subjektit të rivlerësimit i ka dhënë shtetasit B. H. statusin e personit tjetër të lidhur në kuptim të neneve 3, pika 14 dhe 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar faktin e marrjes hua prej këtij shtetasi në deklaratën vetting, si dhe deklaratën e pasurisë në vitin 2009, duke sqaruar se huaja ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament të ndodhur në Golem, Kavajë. Për të provuar huan në shumën 30.000 euro, dhënë nga shtetasi B. H., subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur deklaratës vetting deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2010, të shtetasit B. H., i cili deklaroi se në periudhën mars-prill 2009 i ka dhënë hua pa afat kushëririt Kudus Shahu në vlerën 30.000 euro, me qëllim përdorimin

për nevojat e tij dhe të familjes, dhe se është dakord që kthimi i saj të realizohet në një periudhë të mëvonshme, herë pas here, sipas mundësive të shlyerjes.

109. Pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, për të provuar me dokumentacion justifikues të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur, huadhënësi B. H., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit një ekstrakt regjistrimi të shoqërisë “{\*\*\*}”, nxjerrë nga Regjistri Kombëtar i Tregtisë dhe Shoqërive (RKTSH) Francë<sup>19</sup>. Në këtë akt jepen të dhëna mbi regjistrimin e shoqërisë, kapitalin fillestar dhe formën juridike të shoqërisë, administrator dhe ortak i vetëm i së cilës është shtetasi Y. H.. Nga përmbajtja e këtij akti, trupi gjykues vëren se nuk rezulton asnjë e dhënë që të vërtetojë lidhjen e huadhënësit B. H. me këtë shoqëri apo, për më tepër, të ardhurat e realizuara prej tij.
110. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkë me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit dhe një deklaratë noteriale të kumatës së huadhënësit, znj. M. H., me nr. {\*\*\*}, datë 22.10.2022, e cila konfirmon dhënien e huasë subjektit të rivlerësimit, në vlerën 30.000 euro, nga të ardhurat nga kontributi i gjithë familjes së vjehrrit të saj. Bashkëlidhur kësaj deklarate është ekstrakti i një dokumenti të lëshuar nga organet tatimore franceze, sipas së cilit rezulton se shtetasi B. H. dhe dy nga vëllezërit e tij kanë paguar për periudhën 2021-2022 taksat mbi banesat në pronësi të tyre në Paris. Bashkëlidhur deklaratës noteriale është dhe një dokument me shkrim dore, në frëngjisht, i përkthyer në shqip, firmosur nga shtetasi B. H., i cili deklaron se i ka dhënë hua z. Kudusi Shahu shumën 30.000 euro, për blerjen e një apartamenti. Edhe nga këto akte, trupi gjykues konstaton se nuk rezulton asnjë e dhënë për të ardhurat e huadhënësit B. H. apo për pjesëtarët e tjerë të familjes së tij. Gjithashtu, trupi gjykues çmon, ashtu si ka konstatuar dhe Komisioni, se nuk mund të pranohet shpjegimi i subjektit se shuma e dhënë hua ka qenë kontribut i gjithë familjes H., pasi ky pretendim është ngritur për herë të parë pas kalimit të barrës së provës, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit kishte të gjitha mundësitë ta sqaronte këtë situatë në deklaratat vjetore përkatëse apo në deklaratën *vetting*.
111. Në përfundim, trupi gjykues, nga të dhënat që rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, lidhur me verifikimin e burimit të krijimit të shumës 30.000 euro prej personit tjetër të lidhur, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin ligjor që të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/huadhënësit B. H., për të justifikuar dhënien e huasë, duke mosprovuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume nga huadhënësi, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, është i bazuar qëndrimi i Komisionit që nuk e ka konsideruar këtë hua si burim për blerjen e apartamentit, duke mos e përfshirë vlerën e saj në analizën financiare mbi mundësinë e blerjes së kësaj pasurie.
112. Një nga burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* për blerjen e apartamentit janë dhe të ardhurat e vëllait të tij B. Sh., për të cilin deklaron se ka kontribuar në arredimin dhe rregullimin e banesës në Golem, si rezultat i emigracionit në Greqi dhe Angli, dhe se shuma e përgjithshme e kontributit për të dy objektet, bashkë me banesën në rrugën “{\*\*\*}”, është afërsisht 27.000 euro. Për vërtetimin e këtij deklarimi, subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka paraqitur: (i) deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 24.01.2017, të shtetasit B. Sh., i cili deklaron se: “Z. Kudusi Shahu është vëllai im dhe për shkak të lidhjes familjare

<sup>19</sup> Dokument në gjuhën frënge, i përkthyer dhe i noterizuar.

kam kontribuar në vite në ndërtimin e banesës në rrugën “{\*\*\*}”, si dhe në blerjen dhe rikonstrukcionin e apartamentit të ndodhur në Golem, Durrës [...] në vlerën monetare totale 27.000 euro [...] dhe këtë shumë e ka dhënë për shkak të mundësisë që ka pasur, pasi nga viti 1999 deri në gusht të vitit 2001, pasi ka qenë emigrant në Mbretërinë e Bashkuar; (ii) kopje të dokumentit të lëshuar në datën 09.08.2002, nga *United Kingdom Immigration Service*, në emër të shtetasit B. Sh..

113. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se vëllai ka kontribuar në vlerën në total 27.000 euro për të dy pronat truall dhe ndërtesë në Tiranë, si dhe për pronën apartament me sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>, në Golem, Kavajë. Për pronën në Golem vëllai ka kontribuar në një vlerë të përafërt 17.000 euro, ndërkohë vlera 10.000 euro është përdorur në një masë të përafërt për shtëpinë në rrugën “{\*\*\*}”. Për sa u përket të ardhurave të ligjshme të vëllait, subjekti ka shpjeguar se kontributi prej 27.000 eurosh i është dhënë për shkak të mundësisë që ka pasur vëllai i tij, pasi nga viti 1999 deri në gusht të vitit 2001 ka qenë emigrant në Mbretërinë e Bashkuar, kjo e mbështetur me kopjen e dokumentit të lëshuar në datën 09.08.2002, nga *United Kingdom Immigration Service*, në emër të shtetasit B. Sh., si dhe me e-mail-in e datës 30.11.2022, të *Home Office*, ku përcillet informacion lidhur me qëndrimin e vëllait.
114. Për të provuar të ardhurat e vëllait, subjekti i rivlerësimit ka sjellë bashkë me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit disa mandate të dërgesave të parave<sup>20</sup> me anë të Western Union, për të cilat Komisioni është shprehur se nuk arrijnë të provojnë se janë krijuar me burime të ligjshme, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë punësimin e personit tjetër të lidhur dhe pagesën e detyrimeve tatimore.
115. Komisioni, referuar deklarimeve të subjektit në përgjigje të barrës së provës, duke konsideruar se kontributi i personit tjetër të lidhur, z. B. Sh., për këtë apartament, ka qenë në shumën 2.703.590 lekë<sup>21</sup> (17.000 euro), ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/vëllait për të justifikuar kontributin për krijimin e kësaj pasurie. Komisioni, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin e pasurisë banesë dykatëshe në rrugën “{\*\*\*}”, ka konkluduar se referuar shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit ligjor provues të paraqitur gjatë hetimit administrativ, për sa u përket të ardhurave të vëllait të tij, të deklaruara se janë fituar nga puna si emigrant, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, në kuptim të ligjit, marrëdhënien e punës dhe krijimin e të ardhurave në shumën 27.000 euro, si dhe ligjshmërinë e tyre, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës
116. Trupi gjykues, në referim të sa ka parashtruar subjekti i rivlerësimit në ankim dhe të dokumentacionit që ai ka paraqitur gjatë hetimit administrativ, vëren se subjekti i rivlerësimit paraqet të njëjtat akte dhe pretendime për të ardhurat e vëllait, të cilat, sipas tij, kanë shërbyer për kryerjen e investimeve në banesën e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë dhe në

<sup>20</sup> Formularë për tërheqje parash: (i) vlera 779,62 USD në datën 03.06.1999; (ii) vlera 3.235,49 USD në datën 19.10.1999; (iii) vlera 2.904,28 USD në datën 20.07.2000; (iv) vlera 2.000 USD në datën 25.10.2000; dhe (v) vlera 2.801,36 USD në datën 19.02.2001.

<sup>21</sup> Si diferencë e vlerës 3.703.590 lekë (27.000 euro x 137,17) me 1.000.000 lekë të deklaruara si kontribut në banesën në rrugën “{\*\*\*}”.

apartamentin në Golem, të blerë prej tij në vitin 2011. Në vijim të konkluzionit të arritur nga trupi gjykues në këtë vendim, lidhur me shkakun e ankimit për pasurinë banesë në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, konstatohet se i njëjti përfundim arrihet edhe për burimin e deklaruar nga të ardhurat e vëllait për blerjen e apartamentit në Golem, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë punësimin apo përfitimin e të ardhurave të ligjshme të vëllait në emigracion, për periudhën 1999 – 2001.

117. Trupi gjykues çmon se vetëm deklarimi i kontributit financiar të vëllait në deklaratën e pasurisë *vetting* i pashoqëruar me dokumentacion provues është i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mbi ligjshmërinë e shumës së dhënë si kontribut nga vëllai. Për rrjedhojë, mbetet i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/vëllait për të justifikuar kontributin prej 2.703.590 lekësh, për krijimin e pasurisë apartament të ndodhur në Golem.
118. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, për përfshirjen në analizën financiare për blerjen e apartamentit të të ardhurave të bashkëshortes nga mësimdhënia, këto pretendime janë vlerësuar në këtë vendim, në paragrafët 93-101, dhe është arritur në të njëjtin konkluzion me Komisionin se këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit.
119. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në Komision dhe në ankimin drejtuar Kolegjit (sipas analizës financiare që ka sjellë) se një nga burimet për krijimin e pasurisë apartament në Golem janë dhe të ardhurat nga dhënia me qira e banesës në pronësi të familjes së tij në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë. Të ardhurat nga qiraja subjekti i rivlerësimit i pretendon si burim të ardhurash edhe për blerjen e pasurisë garazh (trajtuar në vazhdim në këtë vendim). Konkretisht, sipas analizës financiare që ka sjellë në ankim, për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit pretendon 150.000 lekë të ardhura nga qiraja e apartamentit, ndërsa për vitin 2010, pretendon 200.000 lekë.
120. Komisioni, lidhur me të ardhurat e pretenduara nga qiraja, ka konkluduar se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me vlerën e të ardhurave të përfituara ndër vite, pasi referuar deklarimeve në deklaratat periodike vjetore, totali i të ardhurave të deklaruara nga qiraja është 1.250.000 lekë dhe 13.500 euro përkundrejt shumës 550.000 lekë dhe 10.200 euro, të deklaruar në deklaratën *vetting*. Të ardhurat nga qiraja të deklaruara nga subjekti për periudhën 2007 – 2015 nuk plotësojnë kriterin e parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për pasojë, nuk mund të merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare. Për pasojë, Komisioni i ka qëndruar konkluzionit në rezultatet e hetimit dhe ka pasqyruar në analizën financiare të ardhura nga qiraja vetëm për vitin 2016, në vlerën 414.000 lekë, referuar deklarimit në DIVA-n e vitit 2016, pasi subjekti ka paguar detyrimet tatimore për këtë vlerë. Në përfundim, për shkak të këtyre rrethanave që lidhen me mospagimin e detyrimeve tatimore, Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë të ardhurat e deklaruara nga subjekti në analizën financiare, i gjendur në kushtet e shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
121. Trupi gjykues, me qëllim analizimin e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, mori në shqyrtim aktet e administruara gjatë hetimit, nga të cilat rezultojnë të dhënat si në vijim.

122. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Dhënia e apartamentit me qira në rrugën “{\*\*\*}” nga vitet 2007 – 2016. Në pjesën më të madhe është dhënë pa kontratë qiraje me afat 1-vjeçar. Për rastet që është mbajtur kontratë bashkëlidhur formularit kopje të kontratës. Shuma: 10.200 euro dhe 550.000 lekë*”.
123. Në deklaratimet periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) në deklaratën e vitit 2007, nga mësimdhënia e bashkëshortes dhe qira nga apartamenti në rrugën “{\*\*\*}”, të ardhura me vlerë 600.000 lekë; (ii) në deklaratën e vitit 2008, vlerën 400.000 lekë; (iii) në deklaratën e vitit 2009, vlerën 150.000 lekë; (iv) në deklaratën e vitit 2010, vlerën 200.000 lekë; (v) në deklaratën e vitit 2011, vlerën 200.000 lekë; (vi) në deklaratën e vitit 2012 nuk ka deklaruar të ardhura; (vii) në deklaratën e vitit 2013, vlerën 225 euro/muaj; (viii) në deklaratën e vitit 2014, vlerën 300 euro/muaj; (ix) në deklaratat e viteve 2015 dhe 2016 ka deklaruar të ardhura nga qiraja e apartamentit në Tiranë (deklaruar më parë qira jo me periudha të rregullta kohore, ndaj dhe kontratat janë me periudhë deri në një vit), me vlerë 300 euro/muaj.
124. Për vërtetimin e të ardhurave të realizuara nga dhënia me qira e apartamentit, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, ka paraqitur si provë kopje të kontratave të qirasë, të datave 01.02.2015, 28.09.2015 dhe 01.11.2016, ndërsa në përgjigje të pyetësorit standard ka paraqitur kontratat e mësipërme, si dhe kontrata të qirasë të datave 01.03.2017, 05.01.2018, 05.01.2019 dhe 04.06.2019.
125. Në procesverbalin e datës 01.02.2016, të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se apartamenti në rrugën “{\*\*\*}” nuk është i regjistruar në ZVRPP dhe, si rrjedhim, nuk janë hartuar kontrata të rregullta qiraje.
126. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë (në vijim “DRT”) ka informuar Komisionin se shtetasi Kudus Shahu nuk ka aktivitet privat të regjistruar në emrin e tij, si dhe është regjistruar për përgjegjësinë tatimore DIVA dhe ka kryer deklaratimet për vitet 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019.
127. Sipas të dhënave të llogarive bankare pranë BKT-së në emër të subjektit, rezulton se është kryer një depozitim nga shtetasi V. K., me vlerë 15.500 lekë, në datën 11.10.2013, me përshkrimin “pagesë qiraje”. Gjithashtu, është depozituar vlera 1.390 euro në vitin 2013 dhe vlera 440 euro për vitin 2014, por pa përshkrim specifik.
128. Komisioni ka kërkuar informacion pranë DRT-së Tiranë për të kryer verifikime të mëtejshme në kontabilitet për pagesat e kryera për tatimin në burim të qirasë dhe, në përgjigje, DRT-ja ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit është i regjistruar vetëm për përgjegjësinë tatimore “Deklaratë individuale vjetore të të ardhurave (DIVA)”, si dhe nuk ka depozituar dhe nuk ka deklaruar pranë DRT-së kontrata qiraje. Nga analizimi i deklaratimeve DIVA, Komisioni ka konstatuar se në DIVA-n e vitit 2015 nuk janë deklaruar të ardhura nga qiraja, ndërsa në atë të vitit 2016 janë deklaruar të ardhura *bruto* nga qiraja në vlerën 414.000 lekë dhe në datën 18.05.2017 ka paguar detyrimin prej 62.100 lekësh.
129. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se referuar nenit 803 të Kodit Civil, që parashikon se kontrata e qirasë për një kohë më të gjatë se një vit duhet të bëhet me shkresë, nuk ka pasur detyrimin të lidhte kontratë me qiramarrësin nëse ky i fundit nuk e

merrte me qira për më shumë se një vit. Për sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja, subjekti i rivlerësimit pretendon se sipas legjislacionit tatimor nuk ka asnjë pengesë për pagimin me vonesë të detyrimeve tatimore, që në rast vonese shoqërohet me pagesë gjobe dhe kamatëvonesash. Sipas subjektit të rivlerësimit, detyrimin e mbajtjes dhe pagesës së detyrimit tatimor e ka pasur gjithmonë qiramarrësi, por pavarësisht këtij fakti ai e ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore sa kohë kjo pagesë nuk është kryer nga qiramarrësit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit referon në ankim dhe nenet 73<sup>22</sup> dhe 100<sup>23</sup> të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se me kalimin e afatit prej 5 vitesh të të drejtës së institucioneve tatimore për vjeljen e detyrimeve tatimore, tatimpaguesi nuk ka asnjë detyrim për të paguar ndonjë tatim për efekt të parashkrimit shues.

130. Lidhur me sa parashtrohet subjekti i rivlerësimit në ankim, sa i përket formës së lidhjes së kontratës së qirasë, trupi gjykues vëren se është e vërtetë që në rastin e një marrëdhënieje qiraje deri në një vit nuk është e detyrueshme lidhja e një kontrate me shkrim mes palëve, sipas parashikimeve të nenit 803 të Kodit Civil. Por në rastin e subjektit të rivlerësimit, ky parashikim ligjor nuk mund të shërbejë për të pretenduar dhe justifikuar të ardhura të ligjshme nga qiradhënia, në kushtet kur ai nuk sjell asnjë akt për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave për periudha të caktuara kohore dhe as dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse. Ndërkohë, trupi gjykues konstaton se pavarësisht pretendimit që nuk ka pasur detyrimin për të lidhur kontratë me shkrim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision disa kontrata të cilat rezultojnë se janë lidhur për një periudhën më pak se një vit, siç janë kontratat e datave 01.02.2015, 28.09.2015 dhe 01.11.2016, të paraqitura në deklaratën *vetting*, si dhe kontratat e qirasë të datave 01.03.2017, 05.01.2018, 05.01.2019 dhe 04.06.2019, të paraqitura në përgjigje të pyetësorit standard.
131. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaratime të ndryshme në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, lidhur me vlerën e të ardhurave të përfituara nga qiradhënia. Ndërsa në deklaratën *vetting* ka deklaruar vlerën 10.200 euro dhe 550.000 lekë, në deklaratat periodike vjetore të pasurisë totali i të ardhurave të deklaruar nga qiraja është 1.250.000 lekë.
132. Trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron as pretendimi i subjektit të rivlerësimit se është detyrim i qiramarrësit mbajtja dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja. Nga analizimi i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rezulton se në nenin 8 (i ndryshuar me ligjin nr. 9161/2003), përcaktohen si të ardhura të tatueshme të ardhurat e realizuara nga individë rezidentë me burim në Republikën e Shqipërisë, ku përfshihen edhe të ardhurat nga qiratë. Gjithashtu, sipas nenit 33<sup>24</sup> të ligjit nr. 8438/1998, i

---

<sup>22</sup> “1. E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës”.

<sup>23</sup> “1. E drejta për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese, sipas këtij kreu, parashkruhet brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhej të kryhej”.

<sup>24</sup> Neni 33 Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat: “1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 15% nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë: [...] ë) pagesat për qiratë.”

ndryshuar, kur marrëdhënia e qirasë është me një individ, siç është rasti në kontratat e qirasë të datave 01.02.2015 dhe 28.09.2015, ka qenë subjekti i rivlerësimit që ka pasur detyrimin për mbajtjen në burim të vlerës së tatimit mbi të ardhurat dhe derdhjen e tyre në llogari të organeve tatimore.

133. Për t'iu rikthyer analizës së burimeve të deklaruara për blerjen e pasurisë apartament në Golem, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, kontrata qiraje nga data 01.02.2015 e në vijim, siç janë kontratat e datave 01.02.2015, 28.09.2015 dhe 01.11.2016, por jo për periudhën e mëparshme të krijimit të pasurisë apartament në Golem, në vitin 2011, si dhe të pasurisë garazh në vitin 2015. Nga të dhënat e llogarive bankare në emër të subjektit të rivlerësimit rezulton një depozitim nga shtetasi V. K., me vlerë 15.500 lekë, në datën 11.10.2013, me përshkrimin “pagesë qiraje”, si dhe depozitime të vlerave 1.390 euro në vitin 2013 dhe 440 euro për vitin 2014, por pa përshkrim specifik. Nga këto transaksione jepen indicie se subjekti ka përfituar të ardhura nga qiraja, por në mungesë të provimit me akte të tjera nuk mund të konkludohet sa kanë qenë këto të ardhura apo nëse është paguar tatimi mbi të ardhurat. Për kontratat që ka sjellë subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, provohet pagesa e detyrimeve tatimore vetëm për të ardhurat e realizuara nga qiraja në vitin 2016<sup>25</sup> dhe, për këtë arsye, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare vetëm këto të ardhura në vlerën 414.000 lekë.
134. Konstatohet se në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit është kontradiktor, për sa deklaron lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore, pasi ndërsa pretendon se për të ardhurat nga qiraja ka paguar detyrimet tatimore, më pas referon legjislacionin tatimor, i cili parashikon se me kalimin e afatit prej 5 vitesh të së drejtës së institucioneve tatimore për vjeljen e detyrimeve tatimore, tatimpaguesi nuk ka asnjë detyrim për të paguar ndonjë tatim për efekt të parashkrimit shues. Me sa duket, subjekti i rivlerësimit kërkon që me këtë referim ligjor të konsiderojë si të ligjshme atë pjesë të të ardhurave të pretenduara nga qiraja për të cilat nuk ka paguar detyrimet tatimore dhe për të cilat është përmbushur afati 5-vjeçar i parashkrimit, sipas neneve 73 dhe 100 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
135. Për sa analizuar më lart, trupi gjykues çmon se vetëm fakti i deklarimit të të ardhurave nga qiraja në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2007 – 2015, në kushtet kur nuk provohet përfitimi i këtyre të ardhurave me dokumentacion ligjor (kontrata), si dhe pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse, nuk mund të shërbejë për të provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, të cilat nuk mund të merren në konsideratë në analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, është i bazuar qëndrimi i Komisionit se të ardhurat nga qiraja të deklaruara nga subjekti për periudhën 2007-2015 nuk plotësojnë kriterin e parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për pasojë, nuk mund të merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare.
136. Në përfundim, për pasurinë apartament me sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>, në Golem, Kavajë, blerë në datën 11.02.2011, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, kontrollon analizën financiare të Komisionit dhe arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, për kryerjen e shpenzimeve,

---

<sup>25</sup> Pasi në DIVA-n e vitit 2015 nuk janë deklaruar të ardhura nga qiraja

shlyerjen e detyrimeve dhe shtesën e kursimeve, për vitet 2009, 2010 dhe 2011 (vitet gjatë të cilëve janë kryer pagesat për këtë apartament), me një balancë negative të paktën sa ajo e rezultuar në Komision, në vlerën prej (-) 9.558.467 lekësh, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion pasi, lidhur me burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, konstatoi se:

**136.1.** Subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, shtetasit B. H., për të justifikuar huan e dhënë prej tij në vlerën 30.000 euro, të deklaruar të përdorur për blerjen e kësaj pasurie.

**136.2.** Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, vëllait B. Sh., për të justifikuar kontributin e tij për krijimin e kësaj pasurie.

**136.3.** Të ardhurat nga qiraja, të deklaruara nga subjekti për periudhën 2007 - 2015, nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për shkak të mosprovimit të tyre dhe mospagimit të detyrimeve tatimore. Për pasojë, këto të ardhura, bashkë me të ardhurat e bashkëshortes nga kurset private të mësimdhënies, nuk u morën në konsideratë në analizën financiare mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortes, për krijimin e kësaj pasurie.

**- Në lidhje me pasurinë garazh me sip. 24,8 m<sup>2</sup>**

- 137.** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë garazh me sip. 24,8 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, në vlerën 10.000 euro. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësimin e kursimeve të mëparshme të deklaruara në vite nga dhënia me qira e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}” dhe një pjesë kontribut i prindërve të tyre. Në seksionin e të dhënave konfidenciale subjekti ka deklaruar: *“Në blerjen e garazhit, krahas investimeve tona familjare, kanë kontribuar në vlerë 5.000 euro, të ndarë në pjesë të barabarta si dhuratë, prindërit e mi dhe të bashkëshortes”*.
- 138.** Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ka paraqitur si dokumentacionin ligjor provues certifikatën për vërtetim pronësie të datës 19.03.2015, për pasurinë garazh, në emër të shtetasit Kudusi Shahu, kartelën e pasurisë së paluajtshme, si dhe kontratën noteriale të shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 26.02.2015.
- 139.** Sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*}, datë 26.02.2015, subjekti ka blerë nga shtetasi A. D. pasurinë garazh në rrugën “{\*\*\*}”, në shumën 10.000 euro. Sipas kësaj kontrate, blerësi ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes, sipas mandateve të datave 19.02.2015 dhe 25.02.2015. Bashkëlidhur kontratës së shitjes, ndër të tjera, është administruar edhe vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 20.12.2014, i lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sipas së cilit z. Kudusi Shahu ka blerë parkimin nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe ndërtimi në total 24,8 m<sup>2</sup>. Shoqëria i ka përcjellë Komisionit dy mandat depozitime në llogarinë bankare pranë BKT-së të noteres M. D., konkretisht në datën 19.02.2015, në vlerën 5.000 euro dhe në datën 25.02.2015, në vlerën 5.000 euro, me përshkrimin *“likuidim detyrimi parkim “{\*\*\*}”, Kudusi Shahu”*.
- 140.** Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë garazh, rezultoi se:



**140.1.** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë garazh “ [...] blerë me pakësimin e kursimeve të mëparshme të deklaruara në vite, një pjesë e kontributit edhe e familjarëve tanë (prindërve tanë)” .

**140.2.** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “[...] burim i krijimit i financimit janë pakësimi i kursimeve të mëparshme të deklaruara në vite nga dhënia me qira e apartamentit në “{\*\*\*}” dhe një pjesë kontribut i prindërve tanë”. Në pyetësorin nr. 1, fillimisht subjekti ka deklaruar se: “[...] në vitin 2015, për shkak se garazhi është blerë në datën 26 shkurt i duhej të pakësonte kursimet e viteve të mëparshme dhe, si pasojë, ka pakësuar rreth 1.400.000 lekë, gjendjen cash të deklaruar më parë [...]” dhe, më pas, lidhur me pyetjen e Komisionit se cili është burimi i krijimit të shumave të dhëna dhuratë nga prindërit e tij dhe të bashkëshortes së tij, deklaroi se vjehri i tij ka kontribuar në shumën 5.000 euro.

**140.3.** Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kontribuesi kryesor ka qenë vjehri H. B., i cili ka punuar si inxhinier gjeolog dhe ka pasur zyrën e tij private ku punonte me nxjerrjen e licensave minerare dhe ka pasur mjaftueshëm të ardhura dhe gjendje në llogari, për të justifikuar kontributin e tij në masën 5.000 euro në blerjen e garazhit. Arsyeja e blerjes së këtij garazhi ka qenë kërkesa e djalit drejtuar gjyshërve të tij, të cilët ia mundësuan që në vitin 2011, por për shkak të nevojave në shlyerjen e detyrimeve për pasuritë e paluajtshme u përdorën gjatë atij viti, duke i premtuar djalit plotësimin e shumës dhe blerjen me mundësinë e parë të krijuar, dhe kjo gjë u mundësua në vitin 2015.

**140.4.** Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një *statement* të llogarisë individuale të vjehrit në Raiffeisen Bank, me kreditime të cilat vijnë nga paga dhe shërbimet që ka kryer kundrejt të tretëve, një *statement* të llogarisë në Credins Bank që tregon aftësinë paguese, si dhe një deklaratë huaje, e cila, sipas subjektit, tregon që ka patur gjendje kreditore dhe mundësinë për të dhënë hua.

**141.** Për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se, pavarësisht se dokumentacioni i paraqitur potencialisht provon mundësinë e kontributit të vjehrit në vlerën 5.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka krijuar një situatë kaotike lidhur me mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, duke bërë të pamundur identifikimin e situatës faktike lidhur me krijimin e kësaj pasurie, mbi bazën e së cilës do të mund të kryhej kontrolli dhe vlerësimi i kësaj pasurie, sipas përcaktimeve në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për rivlerësimin kalimtar. Ky konkluzion bazohet në analizimin e deklarimeve të subjektit ndër vite, ato gjatë procesit të rivlerësimit dhe veçanërisht deklaratimit të subjektit në prapësime, i cili e zhvendos kontributin e pretenduar prej 5.000 eurosh, nga viti 2015 në vitin 2011, një pretendim ky i paraqitur për herë të parë vetëm pas kalimit të barrës së provës. Për rrjedhojë, Komisioni ka krijuar bindjen se pasaktësitë në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklarin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**142.** Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar të njëjtat argumente si në Komision, se kontribuesi kryesor për blerjen e kësaj pasurie ka qenë vjehri i tij, i cili ka pasur mundësi financiare për të ndihmuar në shumën 5.000 euro. Kjo shumë i është dhënë djalit të subjektit të rivlerësimit për blerjen e garazhit në vitin 2011, por u përdor për shlyerjen e detyrimeve që subjekti i rivlerësimit ka pasur në këtë vit, dhe u zëvendësua më vonë, në vitin

2015, për blerjen e pasurisë garazh. Subjekti i rivlerësimit sqaron se ka deklaruar se blerja është bërë nga pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 1.400.000 lekë, pasi po kaq kushtonte garazhi dhe kontributi i familjarëve në të cilën ka nënkuptuar, pikërisht, origjinën e shumës dhe qëllimin e dhënies së saj nga gjyshërit.

143. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar në pikën 6.16 të vendimit se vërtetohet burimi i të ardhurave për vlerën 5.000 euro, dhe ky fakt nuk mund të përligjë konkluzionin e Komisionit se për shkak të informacionit kaotik subjekti ka qenë në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
144. Në vlerësim të sa parashtron subjekti i rivlerësimit në ankim, lidhur me qëndrimin e Komisionit për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.
145. Komisioni, nisur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* për burimet e krijimit të pasurisë garazh, ka analizuar mundësinë e kursimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për vlerën 5.000 euro, si dhe mundësitë e personave të tjetër të lidhur, prindërit e bashkëshortes dhe prindërit e subjektit, për të dhuruar respektivisht shumën 2.500 euro për blerjen e garazhit.
146. Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën gjatë të cilës janë krijuar këto kursime, konkretisht për vitet 2013 dhe 2014 dhe rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtesën e kursimeve dhe krijimin e shpenzimeve gjatë vitit 2014, me një balancë negative prej (-) 809.336 lekësh.
147. Lidhur me mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni fillimisht ka konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti dhe ai i administruar nga hetimi nuk justifikon të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëshortes për dhurimin e vlerës 2.500 euro. Ndërsa lidhur me burimin e shumës 2.500 euro, të dhuruar nga prindërit e tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues për të ardhurat e prindërve.
148. Për të vërtetuar të ardhurat e vjehrrit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dokumentacionin provues: (i) kopje të ekstraktit të QKB-së së shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; (ii) kopje të licencës të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; dhe (iii) dorëshkrim lidhur me listën e detyrimeve të subjekteve. Komisioni, duke iu referuar këtyre akteve, në përfundim, ka konstatuar se potencialisht provohet mundësia e personit tjetër të lidhur, vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, për të dhuruar shumën 5.000 euro.
149. Në vijim të të dhënave të sipërcituara, trupi gjykues vëren se në vlerësimin e Komisionit peshën kryesore për verifikimin e burimeve të krijimit të pasurisë garazh e kanë marrë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, pavarësisht faktit se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në Komision potencialisht provon mundësinë e kontributit të vjehrrit në vlerën 5.000 euro. Trupi gjykues, në raport me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit, ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin për deklarime kaotike të tij lidhur me identifikimin e situatës faktike për krijimin e kësaj pasurie. Vlerësohet

se qasja e subjektit të rivlerësimit, i cili ka shfaqur dukshëm mungesë koherence në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë garazh dhe dhurimit të shumës 5.000 euro, duke e ndryshuar atë në varësi të nevojave të mbulimit të rezultateve të hetimit, e bën të pabesueshëm pretendimin e tij përfundimtar se si burim duhet konsideruar dhurimi i vjehrrit, pavarësisht faktit se potencialisht vjehrrin e subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhuruar shumën 5.000 euro.

150. Për sa më sipër, për pasurinë garazh me sipërfaqe 24,5 m<sup>2</sup>, në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për shkak të deklaratimeve kontradiktore, lidhur me burimet për krijimin e kësaj pasurie, duke bërë të pamundur identifikimin e situatës faktike mbi bazën e së cilës do të mund të kryhej kontrolli dhe vlerësimi për këtë pasuri, sipas përcaktimeve në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për rivlerësimin kalimtar.
151. Lidhur me shkakun e ankimit për deklarin e gjendjes *cash*, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.
152. Komisioni ka konstatuar se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje të likuiditeteve *cash*, ndërkohë që referuar deklaratimeve periodike vjetore gjendja *cash* në fund të vitit 2016 rezulton në shumën 2.100.000 lekë. Për këtë arsye, Komisioni, në pyetësin nr. 1, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të saktësojë gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar në fund të secilit vit kalendarik, për periudhën 2013 – 2016. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto gjendje *cash*: vlerën 500.000 lekë në fund të vitit 2013; vlerën 1.400.000 lekë në fund të vitit 2014; vlerën 1.100.000 lekë në fund të vitit 2015; dhe vlerën 2.100.000 lekë në fund të vitit 2016.
153. Për sa rezultuar më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se ka mospërputhje midis gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting* (0 lekë) dhe asaj të përlogaritur nga deklaratimet periodike vjetore, në fund të vitit 2016 (2.100.000 lekë). Lidhur me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime në prapësimet e tij në Komision.
154. Në përfundim, Komisioni, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime lidhur me konstatimin e mësipërm, ka konkluduar se mospërputhja e evidentuar midis shumës së likuiditeteve *cash* të deklaruara në deklaratën *vetting* dhe asaj të përlogaritur referuar deklaratimeve vjetore do të vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.
155. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nuk ka dhënë shpjegime në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, pasi gjendja *cash* është ajo që ka llogaritur dhe plotësuar Komisioni në analizën financiare. Paqartësia në plotësimin e deklaratës *vetting* ka qenë pasi kjo gjendje ishte fizike në shtëpi, por nuk është deklaruar, pasi ishte e destinuar në funksion të shlyerjes së detyrimeve të mbetura. Sipas subjektit, kjo pasaktësi në deklaratimet e gjendjes *cash* nuk mund të shërbejë si një shkak i vetëm për të konkluduar më tej drejt përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit apo të përbërë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

156. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve, konstaton se në deklaratat periodike vjetore ndër vite subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
- Në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003: gjendje *cash* 8.000 USD, banesë, kursime në vite;
  - Në deklaratën e vitit 2004: tërheqje gjendje *cash* 8.000 USD, përdorim për ndërtim shtëpie;
  - Në deklaratën e vitit 2005: nuk ka deklaruar shtesa/pakësime/gjendje të likuiditeteve *cash*<sup>26</sup>;
  - Në deklaratën e vitit 2006: deklaroi si burim për krijimin e pasurisë apartament pakësim 800.000 lekë të deklaruara në deklaratën e mëparshme;
  - Në deklaratat e viteve 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësime/gjendje të likuiditeteve *cash*;
  - Në deklaratën e vitit 2012: pakësim të gjendjes *cash* për likuidim detyrim (1.000.000 lekë)<sup>27</sup>;
  - Në deklaratën e vitit 2013: shtim të gjendjes *cash* për likuidim detyrim (5.000.000 lekë);
  - Në deklaratën e vitit 2014: shtim të gjendjes *cash* për likuidim detyrim (9.000.000 lekë);
  - Në deklaratën e vitit 2015: shtim të gjendjes *cash* për likuidim detyrim (1.100.000 lekë);
  - Në deklaratën e vitit 2016: shtim të gjendjes *cash* për likuidim detyrim (1.000.000 lekë).
157. Në procesverbalin e datës 01.02.2016, të ILDKPKI-së, subjekti ka sqaruar se shtesat në vitin 2013 në shumën 5.000.000 lekë dhe në vitin 2014, në shumën 9.000.000 lekë, janë lapsus në deklaram, pasi i ka deklaruar në të vjetra, si dhe saktëson se shtesat kanë qenë në vlerën 500.000 lekë (viti 2013) dhe 900.000 lekë (viti 2014). Gjithashtu, ka saktësuar se gjendja *cash* në datën 31.12.2014 ka qenë në shumën 1.400.000 lekë.
158. Në sqarimet e dhëna në Komision gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto gjendje *cash*: vlerën 500.000 lekë në fund të vitit 2013; vlerën 1.400.000 lekë në fund të vitit 2014; vlerën 1.100.000 lekë në fund të vitit 2015; dhe vlerën 2.100.000 lekë në fund të vitit 2016. Për vlerën 1.400.000 lekë, që ka pasur gjendje në fund të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se është pakësuar në vitin 2015, për shkak të blerjes së pasurisë garazh në datën 26 shkurt të këtij viti dhe se gjendja *cash* në fund të vitit 2015 ka qenë 1.100.000 lekë.
159. Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në analizën financiare përfundimtare, e ka konsideruar gjendjen *cash* në fund të vitit 2016, në vlerën 2.100.000 lekë.
160. Lidhur me sa parashtroi subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se lidhur me situatën e mosdeklarimit të gjendjes *cash*, ai pretendon se e ka konsideruar të panevojshëm sqarimin në Komision, pasi ka konstatuar se Komisioni e ka përfshirë shumën *cash* në analizën financiare. Trupi gjykues vëren se ky sqarim i subjektit, pavarësisht se ka pasur një deklaram konsistent prej tij të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore, deri në deklaratën e fundit të vitit 2016, para dorëzimit të deklaratës *vetting*, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia për deklaram të plotë të gjendjes *cash* edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe fakti i mosdeklarimit e vendos atë në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me përcaktimet e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>26</sup> Subjekti ka deklaruar shtesë depozite nga paga në Raiffeisen Bank në shumën 450.000 lekë, por jo likuiditete jashtë sistemit bankar.

<sup>27</sup> Më tej, tek seksioni i detyrimeve ka deklaruar se vlera për shlyerjen e detyrimit prej 1.500.000 lekësh ka si burim 1.000.000 lekë nga pakësimi i gjendjes dhe 500.000 lekë nga kursimet dhe pagat e vitit 2012.

161. Trupi gjykues, gjithashtu, mori në analizë edhe pretendimet e subjektit lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, duke kundërshtuar analizën financiare të Komisionit, ka paraqitur një analizë të tijën, e cila rezulton e njëjtë me atë të paraqitur në Komision në kuadër të prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit. Subjekti i rivlerësimit pretendon korrigjimin e analizës financiare të Komisionit, duke iu referuar pretendimeve të tij mbi të ardhurat dhe shpenzimet, të trajtuara më sipër në këtë vendim. Sipas analizës financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, të ardhurat totale për të gjithë periudhën 1991 – 2016 janë në vlerën 39.917.130 lekë dhe pasuritë e krijuara për këtë periudhë janë në vlerën 26.361.012 lekë. Për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2016 balancat negative janë minimale, në total në vlerën (-) 481.560 lekë.
162. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të kryer në Komision dhe konsideron disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi të drejtë konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen në analizë të të ardhurave të pretenduara nga mësimdhënia e bashkëshortes dhe nga dhënia me qira e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, duke konkluduar se:
- Për periudhën 1993 – 2003, periudhë që i përket një pjese të ndërtimit të banesës së subjektit të rivlerësimit, subjekti rezulton me një diferencë negative në shumën (-) 6.039.210 lekë, ndërsa për vitin 2004, kur është deklaruar edhe ndërtimi i pjesës tjetër të banesës, në vlerën 4.000.000 lekë, analiza e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor ka konfirmuar diferencën negative të konstatuar nga Komisioni, në vlerën (-) 698.124 lekë.
  - Subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, si dhe për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve dhe shlyerjen e detyrimeve, edhe për vitet 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, 2015 dhe 2016, në total në vlerë të paktën sa ajo e rezultuar në Komision, në vlerën prej (-) 13.982.376 lekësh.
- Kjo pamjaftueshmëri financiare përjashton zbatimin e parimit të proporcionalitetit të parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
163. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Kudus Shahu nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve në pikat 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi nr. 597, datë 12.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 597, datë 12.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Kudusi Shahu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 17.07.2025.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*